



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 20.07.2023

Nr. 68 i vendimit
Datë 30.09.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.09.2025, ditën e martë, ora 11:20 në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 34/2023 (JR), datë 20.07.2023, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 647, datë 14.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës, nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 647, datë 14.04.2023, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) ka mosdeklarime të pasurive; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.
5. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të

përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016¹.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 647, datë 14.04.2023, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër [...].*
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

➤ Për kriterin e vlerësimit të pasurisë Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani: (i) ka kryer deklarime kontradiktore, të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, sipas parashikimit të germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet, sipas germës “b” të pikës 5; (iii) ka kryer deklarim të rremë sipas germës “c” të pikës 5; (iv) është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit sipas germës “d” të pikës 5. Për rrjedhojë, ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin pasuror që, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, përbën shkak për shkarkimin nga detyra.*

➤ Për kriterin e kontrollit të figurës: *Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të grupit të punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

➤ Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale [...], Komisioni vlerësoi se subjekti ka treguar aftësi profesionale sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Sa u takon problematikave në drejtim të aftësive organizative, parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, në një vlerësim tërësor të rrethanave, si dhe pasojave që kanë sjellë, natyrës së çështjeve të gjykuara apo ngarkesës në punë të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se ato nuk mjaftojnë për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht. Por këto problematika në disa raste të përsëritura, si dhe qëndrimi i subjektit në lidhje me mangësitë e evidentuara, e cila jo në pak raste ka dhënë parashtrime të përgjithshme të pabazuara në*

¹ Shih raportin e KLGj-së “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016” me nr. {***} prot., datë 26.04.2019, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 29.04.2019.

dokumente shkresore ose mungon të ketë dhënë deklarime/parashtrime/dokumente në lidhje me konstatimet e Komisionit, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave sipas pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim: Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave të çështjes objekt rivlerësimi, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit, më datë 05.06.2023, ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 647, datë 14.04.2023 dhe, bazuar në nenin 66 pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 647, datë 14.04.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Izabela Radovani, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në

dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 647, datë 14.04.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13. Më datë 22.09.2025, ankuesja depozitoi në Kolegj parashtrime me shkrim lidhur me ankimin e saj, së bashku me disa akte shkresore², për të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provave të reja në gjykim.
14. Trupi gjykues, bazuar në parashikimet ligjore të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja ‘a’ e të njëjtit ligj, si edhe nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, konstatoi se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet me shkrim, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit për marrjen e këtyre provave.
15. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

16. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), duke parashtruar se Komisioni ka shkelur një sërë të drejtash dhe garancish procedurale të garantuara nga këto dispozita, të interpretuara edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit është marrë në kushtet e një hetimi administrativ të paplotë, mbi bazën e një çmuarjeje të gabuar të provave të administruara, si dhe në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, proporcionalitetit dhe objektivitetit, sigurisë juridike, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, si edhe të pavarësisë dhe paanësisë. Këto pretendime trajtohen si më poshtë.

² Mandatpagesë nr. {***}, datë 3.02.2009 – shuma 1.000.000 lekë; mandatpagesë nr. {***}, datë 30.08.2008 – shuma 1.000.000 lekë, shënim “likuidim dyqani”; mandatpagesë nr. {***}, datë 31.07.2007 – shuma 1.000.000 lekë, shënim “likuidim për dyqan”; mandatpagesë nr. {***}, datë 18.09.2024 – shuma 4.610 euro, shënim “likuidim komplet dyqani”; mandatarkëtim nr. {***}, datë 02.10.2014 – shuma 500.000 lekë, shënim “500.000 : 140 = 3.571 €”; si dhe një analizë financiare të detajuar për vitet 1996 – 2003 dhe 2004 – 2016.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, për shkak se nuk janë administruar disa prova që ajo i konsideron të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, ndër të cilat edhe një opinion i dytë ligjor nga ILDKPKI-ja, si dhe prova të tjera që lidhen me situatën e konfliktit në dukje të interesit, të cilën Komisioni e ka konsideruar në mbështetje të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sipas subjektit, Komisioni ka kryer një vlerësim të gabuar si të provave të administruara prej tij gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu edhe të provave të paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ dhe përpara zhvillimit të seancës dëgjimore.
18. Lidhur me pretendimin se Komisioni ka kryer një hetim të paplotë për sa i përket situatës së konfliktit në dukje të interesit, për shkak të mosmarrjes së një opinionit të dytë nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me kryerjen e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe me hartimin e raportit përkatës. Megjithatë, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ushtron një funksion kushtetues të pavarur kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk kushtëzohet dhe as nuk lidhet me përfundimet e organeve ndihmëse të procesit.
19. Dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit, përcaktojnë qartë raportin ndërmjet organeve të rivlerësimit dhe organeve të specializuara. Ato nuk i detyrojnë organet e rivlerësimit të ndjekin përfundimet e këtyre organeve, por as nuk i pengojnë t'u drejtohen atyre për marrjen e një opinionit të specializuar shtesë, kur kjo diktohet nga rrethanat konkrete të çështjes. Megjithatë, kjo mundësi nuk përbën një detyrim procedural që duhet të zbatohet në çdo rast. Organet e rivlerësimit, mbi bazën e fakteve dhe provave të administruara, ligjit të zbatueshëm dhe ekspertizës së tyre juridike, arrijnë në një vendimmarrje të pavarur dhe të pakushtëzuar nga opinionet e organeve ndihmëse.
20. Në rastin konkret, trupi gjykues nuk çmon të nevojshme marrjen e një opinionit të dytë nga ILDKPKI-ja, ndërsa vlerësimi i situatës konkrete të konfliktit në dukje të interesit do të trajtohet dhe analizohet në vijim të këtij vendimi.
21. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me çmuarjen e gabuar të provave³ nga ana e Komisionit, trupi gjykues vlerëson se shqyrtimi i pretendimeve që kanë të bëjnë me mënyrën se si Komisioni ka vlerësuar faktet dhe provat, si dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje, përbën pjesë të analizës së shkaqeve konkrete të ankimit në lidhje me themelin e çështjes dhe do të trajtohet në vijim të këtij vendimi.
22. Subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, pretendoi se procesi është shoqëruar me shkeljen e parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, pasi, sipas saj, vendimi objekt ankimi nuk

³ Subjekti veçon dokumentacionin në lidhje me procesin gjyqësor me paditës shtetasin Gj.M., i cili ka dhënë informacion të plotë të të gjitha veprimeve paraprake të subjektit si gjyqtare e çështjes; dokumentacionin bankar në lidhje me të ardhurat e ligjshme si kompensim për burgimin politik të padrejtë të familjarëve të subjektit; dokumentacionin e veprimtarisë së bashkëshortit të subjektit si person fizik "noter" dhe mungesën e dokumentacionit ligjor nga Drejtoria Rajonale {***}; dokumentacionin ligjor në lidhje me kohën dhe mënyrën e blerjes së pasurisë me sipërfaqe 34,5 m² nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit; dokumentin "Aktmarrëveshje", datë 19.02.2008, i cili nuk është analizuar sipas rrethanave objektive e subjektive dhe pa e mbështetur në dokumentacionin tjetër shoqëruar.

ka qenë as i nevojshëm dhe as i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të ligjit, duke mos ruajtur një raport të drejtë ndërmjet interesit publik që synon të mbrojë dhe cenimit të të drejtave e interesave të saj legjitime. Sipas subjektit, Komisioni, në përpjekje për të mbrojtur interesin publik, ka cenuar në mënyrë të pajustificuar të drejtat e saj private, duke aplikuar masën më të rëndë disiplinore mbi bazën e fakteve dhe gjetjeve të cilat, edhe nëse do të konsideroheshin të provuara, nuk do të justifikonin, në dritën e parimeve kushtetuese që udhëheqin procesin e rivlerësimit, shkarkimin nga detyra.

23. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se vendimi objekt ankimi është mbështetur kryesisht në analizën dhe vlerësimin e të gjitha pasurive të deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*, ku për disa prej tyre është konstatuar mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e tyre, sipas arsytimit të detajuar të paraqitur në këtë vendim.
24. Në vijim të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se proporcionaliteti përbën një nga parimet që udhëheqin procesin e rivlerësimit dhe duhet të vlerësohet në raport me tërësinë e rrethanave faktike dhe juridike të çështjes konkrete. Ai nuk mund të zbatohet në mënyrë të shkëputur nga kushtet dhe pasojat ligjore të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Për sa kohë Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme financiare dhe pasaktësive në deklarime, situata faktike dhe juridike e konstatuar nuk mbështet pretendimin e subjektit se masa e shkarkimit nga detyra është joproporcionale në raport me qëllimin e ligjit dhe shkaqet mbi të cilat ajo është bazuar.
25. Subjekti pretendoi se gjatë procesit, është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike, pasi, sipas saj, nga rezultatet e hetimit administrativ dhe praktika e deritanishme vendimmarrëse e Komisionit, ishte krijuar një pritshmëri legjitime se ndaj saj nuk do të aplikohesh masa e shkarkimit nga detyra. Ajo argumentoi se, përderisa në rezultatet e hetimit nuk i ishte atribuar ndonjë shkelje e rëndë në kuadër të tri kriterëve të rivlerësimit dhe nuk i ishte bërë me dije ndonjë referencë ligjore që të paralajmëronte aplikimin e masës ekstreme disiplinore, nuk mund të penalizohesh, përveç rasteve kur do të dilnin prova të reja ose do të argumentohesh një nivel më i lartë cenimi.
26. Subjekti pretendoi gjithashtu se siguria juridike është cenuar edhe për shkak se, në vendimmarrjen e Komisionit gjatë periudhës mars 2018 – maj 2023, subjekte të tjera të rivlerësimit, të gjendura në rrethana të ngjashme apo edhe më të rënda, nuk janë ndëshkuar me shkarkim nga detyra. Sipas saj, siguria juridike presupozon besueshmërinë e individit ndaj shtetit dhe qëndrueshmërinë e mënyrës së zbatimit të ligjit, ndaj vendimi objekt ankimi ka cenuar pritshmëritë e saj legjitime.
27. Në vlerësim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit nuk gjejnë mbështetje në ligjin nr. 84/2016. Referuar nenit 52, pika 2 e këtij ligji, Komisioni ka detyrimin që, në përfundim të hetimit administrativ, t'i kalojë subjektit barrën e provës pasi të ketë arritur në përfundimin se provat e mbledhura deri në atë moment, mbështesin gjetjet paraprake të hetimit. Kjo fazë procedurale nuk nënkupton dhe as nuk kërkon përcaktimin paraprak të pasojës ligjore që mund të rrjedhë nga gjetjet e konstatuara.
28. Përcaktimi në rezultatet e hetimit i referencës ligjore konkrete ose i masës disiplinore që mund të vendosej në përfundim të procesit, do të përbënte, në vetvete, një paragjykim të

vendimmarrjes nga ana e Komisionit. Kjo për arsye se, sipas nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vendimi merret vetëm pasi subjekti të ketë ushtruar të drejtën për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, të ketë paraqitur prova dhe shpjegime shtesë dhe të jetë dëgjuar në seancë dëgjimore publike, ku mund të përmbysë ose të zbehë gjetjet paraprake të Komisionit. Për rrjedhojë, fakti që në rezultatet e hetimit, subjektit nuk i është bërë me dije pasoja disiplinore e mundshme, nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike.

29. Po kështu, i pabazuar vlerësohet edhe pretendimi i subjektit se pritshmëritë e krijuara nga vendimmarrja e mëparshme e Komisionit dhe dhënia e një vendimi të ndryshëm në rastin e saj kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Në thelb, ky pretendim përbën edhe një pretendim për ekzistencën e standardeve të shumëfishta në vendimmarrjen e Komisionit.
30. Trupi gjykues sjell në vëmendje se referimi në vendime të tjera të Komisionit nuk mund të përbëjë, *a priori*, shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi apo për të pretenduar cenim të sigurisë juridike. Referuar juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese dhe ligjore, Kolegji ushtron kontroll gjyqësor vetëm mbi vendimin konkret të ankimit, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, rrethanave faktike të provuara dhe zbatimit të ligjit në rastin konkret. Për këtë arsye, Kolegjit nuk mund t'i atribuohet roli i krahasimit abstrakt të vendimeve të Komisionit të dhëna ndaj subjekteve të ndryshme të rivlerësimit, edhe në rastet kur, në pamje të parë, ato paraqesin ngjashmëri faktike.
31. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit ndaj subjektit nuk ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Ndërkohë, pretendimet që lidhen me mënyrën konkrete të vlerësimit të fakteve, provave dhe rrethanave nga Komisioni, si dhe ndikimi i tyre në vendimmarrje do të trajtohen në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve konkrete të ankimit që lidhen me themelin e çështjes.
32. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi vendimi i Komisionit është i paarsyetuar dhe, për pasojë, i pavlefshëm. Sipas subjektit, detyrimi për arsyetimin e vendimit, me natyrë kushtetuese, përbën një garanci themelore procedurale, pasi cilësia dhe ligjshmëria e vendimmarrjes mund të verifikohen vetëm nëpërmjet analizës së rrethanave të faktit, provave dhe shkaqeve juridike mbi të cilat organi vendimmarrës ka mbështetur përfundimet e tij. Subjekti pretendoi se arsyetimi i vendimit duhet të pasqyrojë dhe të trajtojë pretendimet dhe argumentet e ngritura prej palës, duke u dhënë atyre përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar. Sipas saj, po të ishin marrë në konsideratë dhe analizuar të gjitha provat e paraqitura gjatë procesit, Komisioni do të kishte arritur në një përfundim të ndryshëm nga shkarkimi i saj nga detyra.
33. Në vijim, subjekti pretendoi se përshkrimi i fakteve dhe arsyetimi juridik i vendimit duhet të jenë të parashikueshme dhe në përputhje me argumentet e ngritura gjatë procesit, duke iu referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, konkretisht çështjes *Galich kundër Rusisë*, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese (vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 51, datë 21.11.2013; nr. 3, datë 19.02.2013 etj.). Sipas subjektit, vendimi i arsyetuar përbën garancinë që organi vendimmarrës nuk është mbështetur në prova të panjohura, të paligjshme apo të dyshimta, për të cilat subjekti nuk ka pasur dijeni dhe mundësi efektive kundërshtimi.

34. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vlerëson se ato lidhen kryesisht me mënyrën se si Komisioni ka vlerësuar provat dhe qëndrimet e subjektit, si dhe me mospajtimin e këtij të fundit me përfundimet e arritura në vendimmarrje. Vetë fakti që Komisioni ka vlerësuar provat ndryshe nga pritshmëritë e subjektit, nuk nënkupton, në vetvete, mungesë arsyetimi të vendimit dhe, aq më pak, nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e tij.
35. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit objekt ankimi, trupi gjykues konstaton se ai përmbush kërkesat formale të përcaktuara në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe përmban ekspozimin e fakteve, analizën e provave, vlerësimin juridik dhe arsyetimin mbi të cilin Komisioni ka mbështetur qëndrimet e tij përfundimtare. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për mungesë arsyetimi dhe pavlefshmëri të vendimit rezulton i pambështetur në fakt dhe në ligj.
36. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk i ka bërë të ditur motivacionin, referencën ligjore dhe bazën konkrete mbi të cilën do të mbështeste eventualisht shkarkimin e saj nga detyra. Sipas subjektit, Komisioni ka zgjeruar në mënyrë të pajustificuar shkaqet e shkarkimit edhe nëpërmjet një vlerësimi tërësor të procedurave dhe të elementeve që lidhen me etikën, duke zbatuar në mënyrë selektive dispozitat ligjore dhe duke vepruar në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës, sundimit të ligjit, mënjanimit të arbitraritetit, barazisë para ligjit dhe kushtetutshmërisë së procesit.
37. Subjekti pretendoi gjithashtu se procesi i rivlerësimit ndaj saj është zhvilluar në kushtet e një hetimi administrativ të njëanshëm, në kundërshtim me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke cenuar parimet e hetimit të plotë administrativ dhe të çmuarjes së drejtë të provave. Sipas saj, këto shkelje kanë sjellë një vendimmarrje të padrejtë, të pambështetur në ligj dhe në prova, si dhe në kundërshtim me standardet kushtetuese dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca e GjEDNj-së dhe e Gjykatës Kushtetuese.
38. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit për mosnjohjen paraprake të rezultatit të pritshëm të procesit, të motivacionit përfundimtar apo të referencës ligjore mbi të cilën mund të mbështetej një masë disiplinore, nuk gjen mbështetje në ligjin nr. 84/2016. Referuar dispozitave që rregullojnë procesin e rivlerësimit, Komisioni ka detyrimin t'i kalojë subjektit barrën e provës dhe t'i krijojë mundësinë për të paraqitur shpjegime dhe prova shtesë, duke vijuar më pas me zhvillimin e seancës dëgjimore publike.
39. Nga analiza e procesit administrativ të zhvilluar në Komision, përgjatë periudhës nga data 22.06.2020, kur me vendimin nr. 1 është vendosur fillimi i hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, deri në datën 05.04.2023, kur me vendimin nr. 4 është vendosur thirrja e saj në seancë dëgjimore, rezulton se ndërmjet subjektit dhe Komisionit ka pasur një komunikim të vazhdueshëm procedural, nëpërmjet pyetësorëve, shpjegimeve respektive dhe njoftimit të rezultateve të hetimit për të tria kriteret e rivlerësimit.
40. Subjekti është njohur me aktet e dosjes, ka ushtruar të drejtën për të kundërshtuar barrën e provës nëpërmjet paraqitjes së shpjegimeve dhe provave në funksion të mbrojtjes së saj dhe është dëgjuar në seancën dëgjimore publike të datës 12.04.2023, gjatë së cilës ka paraqitur qëndrimet dhe provat që ka çmuar të nevojshme. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni, ka respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit, ndërsa pretendimet e subjektit për cenim të standardit të hetimit administrativ,

të parimeve të kontradiktoritetit, barazisë së armëve, mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë, shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe gjësë së gjykuar rezultojnë të pabazuara.

41. Subjekti pretendoi se nuk gjendet në asnjërën prej situatave të parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe se, në mënyrë të paargumentuar, në shpalljen e dispozitivit të vendimit, i është komunikuar masa e shkarkimit nga detyra, ndërkohë që vetëm në vendimin e arsyetuar janë artikuluar gjetje lidhur me kriterin e pasurisë. Sipas subjektit, Komisioni ka vlerësuar se ajo ka treguar integritet, etikë dhe aftësi profesionale, si dhe ka shmangur në mënyrë të vazhdueshme çdo marrëdhënie që mund të krijonte, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, mundësinë e ndikimit nga faktorë të paligjshëm.
42. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me interpretimin dhe zbatimin e rasteve të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë jurisprudencë, është theksuar se secila prej situatave të parashikuara në këtë dispozitë, përbën një bazë autonome faktike dhe juridike për marrjen e masës disiplinore përkatëse, nëse provohen kushtet ligjore të kërkuara për zbatimin e saj.
43. Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, vlerësohet në dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili i ngarkon subjektit të rivlerësimit barrën për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, pavarësisht rezultateve të arritura në kriteret e tjera të rivlerësimit. Në rastin konkret, trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka mbështetur vendimmarrjen e tij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, nuk arrin nivel të besueshëm për sa i përket kriterit të kontrollit të pasurisë. Nëse, në përfundim të procesit të rivlerësimit, deklarimi i subjektit për këtë kriter vlerësohet i pamjaftueshëm, kjo situatë, në mënyrë të pavarur, sjell pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
44. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se mungesa e problematikave në kriteret e figurës dhe të aftësive profesionale përjashton mundësinë e zbatimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton i pabazuar në ligj dhe, si i tillë, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit.

C. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

➤ Në lidhje me pasurinë “apartament” me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër:

45. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën në vlerën 1.800.000 lekë, në datën 15.12.1998, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër.
46. Komisioni, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, ka vlerësuar se: *subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në datën 03.08.1996 dhe as faktin që shuma prej 1.300.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në datën 07.06.1997, ka shërbyer si burim për apartamentin objekt verifikimi. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pagesën në vlerën 1.800.000 lekë, në datën 15.12.1998, për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, sipas parashikimit të pikës 3 të*

nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në analizën financiare të rishikuar, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, balanca negative u zvogëluar në shumën (-) 2.174.521 lekë.

47. Ky konkluzion është mbështetur nga Komisioni në konstatimet se⁴: (i) për sa u takon të ardhurave nga shitja e apartamentit në datën 07.06.1997, subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me faktin se pse vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, ka deklaruar për herë të parë si burim të pasurisë objekt shqyrtimi, shumën prej 1.350.000 lekësh të përfiturar nga kjo shitje; po ashtu, duke mbajtur një qëndrim jobashkëpunues, nuk ka paraqitur sqarime dhe dokumentacion lidhur me krijimin e depozitës bankare të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, duke mbetur e paqartë nëse këto të ardhura kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës apo të pasurisë objekt verifikimi; (ii) subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse për pasaktësitë në deklaratimet e saj lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe çmimin e blerjes së pasurisë; (iii) sa u përket të ardhurave të bashkëshortit, Komisioni ka pranuar të provuar marrëdhëniet e tij të punës dhe ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e realizuara prej tij për periudhën 07.12.1991 - 23.08.1996, në shumën 604.000 lekë; dhe (iv) subjekti ka shtuar gjatë procesit një burim të ri për krijimin e apartamentit të blerë në vitin 1996, pa arritur të shpjegojë bindshëm dhe të provojë burimin e të ardhurave për blerjen e tij, ndërsa të ardhurat e pretenduara nga kompensimi familjar si ish-të përndjekur politikë, jo vetëm që nuk janë deklaruar më parë si burim, por nuk provohet as që janë përfiturar prej saj.
48. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit si të padrejtë dhe të pabazuar, duke parashtruar pretendimet e mëposhtme.
49. Sipas subjektit, pasuria është përfiturar kundrejt çmimit prej 1.800.000 lekësh, të deklaruar saktë në DIPP-në e vitit 2003, ndërsa deklarimi i vlerës 500.000 lekë në deklaratën *vetting*, përbën një pasaktësi të paqëllimshme. Sipas subjektit, burim për krijimin e kësaj pasurie, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm në pronësi të saj, si dhe shuma prej 500.000 lekësh e kursyer nga të ardhurat bashkëshortore.
50. Subjekti kundërshtoi gjithashtu si të gabuar qëndrimin e Komisionit lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në vitin 1996, duke pretenduar se ato rrjedhin nga kompensimi i përfiturar nga familja e saj në datën 07.12.1994, në vlerën 864.897 lekë, dhe në datën 26.07.1996, në vlerën 718.560 lekë, për burgimin dhe vdekjen e padrejtë të babait dhe vëllait të saj.
51. Për sa u takon të ardhurave nga paga e bashkëshortit, subjekti pretendoi se Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë dhe nuk i ka analizuar në mënyrë të plotë të ardhurat e realizuara prej tij si hetues në Elbasan, si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Malësisë së Madhe, të cilat, sipas saj, arrijnë në shumën totale 604.014 lekë dhe duhet të përfshihen në analizën financiare. Ndërkohë, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit si noter, subjekti pretendoi se ato duhet të përlllogariten mbi bazën e një marzhi fitimi neto prej 80% të qarkullimit vjetor, në përputhje me metodologjinë e zbatuar nga vetë Komisioni deri në vitin 2009.

⁴ Paragrafët 43 - 46 të vendimit objekt shqyrtimi.

52. Subjekti kërkoi gjithashtu që në analizën financiare, të përfshihen edhe të ardhurat e përfituara prej saj gjatë periudhës 1992–1996, në formën e trajtimit financiar me bursë si fëmijë jetim gjatë studimeve, të provuara me vërtetimin nr. 162 prot., datë 29.03.2023, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Shkodër.
53. Mbi bazën e këtyre përlllogaritjeve, subjekti pretendoi se analiza financiare për periudhën 1996 - 15.12.1998 rezulton me balancë pozitive në vlerën 645.519 lekë⁵.
54. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të vlerësuara në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor dhe arsyetimin e vendimit të Komisionit, trupi gjyqësor konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
55. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m², nr. pasurie {***}, ZK {***}, adresa lagjja “{***}”, rruga “{***}”, pallati nr. {***}, Shkodër. Pronësi e fituar me akt dhurimi më datë 15.12.1998; në fakt, është paguar vlera 500.000 lekë (të ardhura të përbashkëta) dhe është regjistruar në emrin e bashkëshortit, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera 500.000 lekë, pjesa takuese 50%.*
56. Kjo pasuri rezulton të jetë deklaruar nga subjekti për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003 si: *Apartament banimi 76 m², me vlerë 1,8 milionë lekë, pjesa takuese 50%. Burimi: kursime nga puna.*
57. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi (apartament) me sipërfaqe 151 m²; ½ e kësaj prone e përfitur nga privatizimi i banesave shtetërore (falas) në favor të bashkëshortit me akt dhurimi nga prindërit e tij; vlera e pasurisë falas, 6 nëntor 1997; pjesa tjetër me akt dhurimi, 15 prill 1999.*
58. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së⁶, subjekti ka sqaruar se apartamenti me sipërfaqe 75 m², i deklaruar në vitin 2003, në fakt është blerë, pavarësisht se kontrata është formalizuar si akt dhurimi. Sipas saj, burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga puna e bashkëshortit, i cili ka ushtruar detyrën e hetuesit, më pas të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Malësi e Madhe gjatë viteve 1992-1996, si dhe aktiviteti i tij si noter.
59. E pyetur në lidhje me banesën me sipërfaqe 150 m², të deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka sqaruar se: *[...] Janë dy apartamente në fakt, të deklaruara me sipërfaqet përkatëse 75 m² dhe 76 m². Nuk është pasuri e re.*
60. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: *Hartimi i kësaj kontrate dhurimi është bërë nga noteri, i cili ka zgjedhur këtë mënyrë, noter i zgjedhur nga vetë shitësit. [...] Në fakt, unë kam deklaruar vlerën 1.800.000 lekë, pasi kjo vlerë është paguar realisht, edhe pse është hartuar kontratë dhurimi. Sqaroj se më datë 03.08.1996, me akt shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., notere V. S, kam blerë personalisht një shtëpi banimi, apartament, nga shtetasi D. P., në vlerën 1.300.000 lekë, pasi prisja fëmijën e parë. Kjo vlerë ka qenë e gjitha e imja personalisht nga puna që kam bërë për 11 vite përpara se të*

⁵ Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka prezantuar në përmbajtjen e ankimit një analizë financiare në formë tabelare për periudhën 1996 - 12.12.1998, ku balanca pozitive rezulton në vlerën 656.306 lekë.

⁶ Shih shkresat nr. {***} prot., datë 4.6.2021 dhe nr. {***} prot., datë 9.11.2022 të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit, procesverbalet e datave 18.09.2014 dhe 3.10.2014.

*filloja punën si ndihmësgjyqtare (të cilën e kam filluar më datë 22.08.1996). Ndërsa, për shkaqe subjektive, e kam shitur këtë pasuri me akt shitjeje nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 07.06.1997. Këtë pasuri ia kam shitur shtetasit R. P. në vlerën 1.350.000 lekë. [...] Në kohën që bashkëshorti im ka hartuar kontratën e dhurimit nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 15.12.1998, megjithëse është hartuar kontratë dhurimi, më ka shpjeguar se shumën prej 1.300.000 lekësh nga shitja e apartamentit ua ka dhënë shitësve G., ndërsa vetë ka shtuar vetëm shumën 500.000 lekë⁷.*

61. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në lidhje me konstatimet se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën në vlerën 1.800.000 lekë, të kryer në datën 15.12.1998, për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, duke rezultuar me balancë negative fondesh në shumën (-) 2.379.886 lekë; (ii) ekzistojnë mospërputhje lidhur me mënyrën e përfitimit të pasurisë, pasi kontrata e administruar është kontratë dhurimi, ndërkohë që subjekti deklaroi se pasuria është përfituar nëpërmjet shitblerjes; (iii) ekzistojnë mospërputhje në deklarimin e çmimit të pasurisë, pasi në deklaratën *vetting* është deklaruar shuma 500.000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2003, pranë ILDKPKI-së dhe gjatë procesit të rivlerësimit, është deklaruar çmimi 1.800.000 lekë; dhe (iv) vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e pasurisë shumën prej 1.300.000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit në datën 07.06.1997, me çmim 1.350.000 lekë.
62. Komisioni ka konstatuar gjithashtu se, krahas apartamentit objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 edhe një depozitë bankare në shumën 2.360.000 lekë, me burim të deklaruar kursimet e vajzërisë dhe të bashkëshortit. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se mbetet e paqartë nëse të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në datën 07.06.1997, në shumën 1.350.000 lekë, kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite apo për blerjen e pasurisë objekt verifikimi, duke i kërkuar subjektit të paraqesë sqarime dhe dokumentacion lidhur me vitin, periudhën, historikun dhe burimin e krijimit të depozitës së deklaruar në DIPP-në e vitit 2003.
63. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se, për sa i takon saktësisë së deklaramit, si element i parë i kontrollit pasuror, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe çmimin e blerjes së pasurisë objekt shqyrtimi. Në DIPP-në e vitit 2003, pasuria është deklaruar si e blerë në shumën 1.800.000 lekë, ndërsa në deklaratën *vetting* është deklaruar si e përfituar me akt dhurimi, me shpjegimin se në fakt është paguar shuma 500.000 lekë.
64. Nga vlerësimi në tërësi i deklaramëve të subjektit në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së, në deklaratën *vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se, *de facto*, pasuria është përfituar nëpërmjet një marrëdhënieje shitblerjeje në datën 15.12.1998 dhe jo me dhurim, si

⁷ Subjekti ka paraqitur aktet shkresore: (i) fotokopje të kontratës së shitjes nr. {***}, datë 3.8.1996, sipas së cilës, subjekti i ka blerë shtetasit D. P., një apartament me sip. 76 m², H. {***}, K. {***}, në vlerën 1.300.000 lekë; (ii) fotokopje të kontratës nr. {***}, datë 7.6.1997, sipas së cilës, subjekti i ka shitur në shumën 1.350.000 lekë, shtetasit R. P. një apartament me sip. 76 m², në adresën lagjen “{***}”, rruga “{***}”, p. nr. {***}, H. {***}, K. {***}; (iii) fotokopje të shkresës së ASHK-*{***}*, datë 1.6.2021, sipas së cilës pasuria me nr. {***} ka kaluar në pronësi të shtetasit R. S. P. dhe aktualisht është në pronësi të trashëgimtarëve të këtij të fundit.

dhe është blerë kundrejt çmimit 1.800.000 lekë dhe jo 500.000 lekë, sa është deklaruar në deklaratën *vetting*. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konstatimi i Komisionit lidhur me pasaktësitë në deklarime, është i drejtë dhe i bazuar.

65. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
66. Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të blerë në shumën 1.300.000 lekë në vitin 1996 dhe të shitur në vitin 1997 për shumën 1.350.000 lekë, trupi gjykues konstaton se këto të ardhura janë deklaruar si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, konkretisht në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Nga aktet e administruara, rezulton se as në DIPP-në e vitit 2003⁸ dhe as në deklaratën *vetting*, subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura si burim për krijimin e apartamentit me sipërfaqe 76 m², për të cilin ka deklaruar si burim kursimet nga puna/të ardhurat e përbashkëta.
67. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit të blerë në vitin 1996, të ardhurat nga shitja e të cilit pretendon se kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me shumën 1.300.000 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë në vitin 1996⁹, subjekti ka deklaruar: “Kjo vlerë ka qenë e gjitha e imja personalisht nga puna që kam bërë për 11 vite përpara se të filloja punën si ndihmësgjyqtare (të cilën e kam filluar më datë 22.08.1996)”.
68. Vetëm në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se familja e saj është kompensuar për burgimin dhe vdekjen e padrejtë të babait dhe vëllait të saj me shumën 864.897 lekë, në datën 07.12.1994, dhe me shumën 718.560 lekë, në datën 26.07.1996, duke pretenduar se një pjesë e këtij kompensimi, në vlerën 1.000.000 lekë, është përdorur për blerjen e apartamentit në muajin gusht të vitit 1996. Vetë subjekti ka sqaruar se nuk disponon dokumentacion për të provuar përdorimin e kësaj shume për këtë qëllim.
69. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë procesit, trupi gjykues konstaton se, ndonëse ekzistojnë të dhëna që provojnë përfitimin e kompensimit nga familja B.¹⁰, aktet e administruara janë të pamjaftueshme për të provuar pretendimin e subjektit se nga ky kompensim, ajo ka përfituar dhe përdorur shumën 1.000.000 lekë për blerjen e apartamentit në vitin 1996.
70. Në këtë drejtim, prokura e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.11.1994, e paraqitur nga subjekti për të provuar ekzistencën e kësaj shume dhe përfitimin prej saj të një pjese të të ardhurave, nuk mbështet faktin e pretenduar. Nga përmbajtja e kësaj prokure, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe vëllezërit e saj, Gj., V., A. dhe E. B., kanë autorizuar nënën e tyre, L.

⁸ Referuar deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë, formularit A-1 të saj, rezulton se subjektet deklaruese kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë të paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, për të cilat kanë qenë të detyruar të deklaronin vlerën, vendndodhjen, nr. e regjistrimit, nr. e pasurisë, burimin konkret dhe jo të përgjithshëm të krijimit.

⁹ Kontratë nr. {***} rep., {***} kol., datë 03.08.1996, sipas së cilës, subjekti i ka blerë shtetasit D. P., një apartament me sipërfaqe 76 m², H. {***}, K. {***}, në vlerën 1.300.000 lekë.

¹⁰ Sipas ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të përndjekurve politikë".

B., duke i dhënë tagra të plotë për tërheqjen dhe administrimin e të hollave të përfituara¹¹ nga kompensimi për burgimin e padrejtë të të ndjerit Ç. B. dhe vdekjen e M. B.. Megjithatë, ky akt nuk provon se subjekti ka përfituar konkretisht shumën 1.000.000 lekë, apo se ka pasur të drejtë të përdorte një pjesë të këtyre të ardhurave për nevoja personale, konkretisht për blerjen e apartamentit në vitin 1996.

71. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit lidhur me përfitimin dhe përdorimin prej saj të shumës 1.000.000 lekë nga kompensimi familjar, mbetet deklarativ dhe i pambështetur në prova.
72. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit sa u takon të ardhurave të bashkëshortit për periudhën 27.12.1991 - 23.08.1996, trupi gjykues vëren dhe vlerëson si më poshtë.
73. Për sa u takon të ardhurave në shumën 21.000 lekë, të përfituara nga punësimi i bashkëshortit si hetues në Elbasan gjatë periudhës 01.12.1986 - 01.06.1989, subjekti ka pretenduar ekzistencën e tyre, por ka deklaruar se ato nuk kanë ndikim në analizën financiare, duke e lënë në vlerësimin e Komisionit përfshirjen ose jo të tyre.
74. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se, në konsideratë edhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji¹², sipas të cilit të ardhurat e përfituara në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës së thellë ekonomike dhe niveleve shumë të larta të inflacionit të periudhës së tranzicionit, në përgjithësi paraqesin aftësi të kufizuar kursimi për efekt të krijimit të pasurive me vlerë të konsiderueshme, shuma prej 21.000 lekësh nuk paraqet ndikim domethënës në analizën financiare të kryer në lidhje me pasurinë objekt shqyrtimi.
75. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për periudhën 1991 - 1996, trupi gjykues konstaton se vetë Komisioni ka vlerësuar në vendim se subjekti, nëpërmjet prapësimeve dhe provave të paraqitura, ka arritur të provojë marrëdhëniet e punës së bashkëshortit për periudhën 07.12.1991 - 23.08.1996, fillimisht si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe më pas si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Malësisë së Madhe, duke reflektuar në analizën financiare të ardhurat e realizuara prej tij në shumën 604.000 lekë.
76. Trupi gjykues konstaton se subjekti ka përsëritur në ankim të njëjtat pretendime të ngritura edhe në prapësime, duke pretenduar se Komisioni nuk ka kryer një hetim të plotë dhe nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit në shumën 604.014 lekë. Nga kontrolli i ushtruar mbi përlllogaritjet e Komisionit, rezulton se të ardhurat e bashkëshortit për këtë periudhë, arrijnë në shumën 614.801 lekë, duke rezultuar me një diferencë prej 10.787 lekësh në raport me përlllogaritjen e Komisionit. Kjo diferencë duhet të reflektohet në analizën financiare, pavarësisht ndikimit jodomethënës që paraqet në rezultatin përfundimtar.
77. Në analizë të pretendimeve të subjektit lidhur me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si noter nga bashkëshorti i saj, trupi gjykues vëren se Komisioni, në mungesë të informacionit të plotë mbi fitimin neto të realizuar, ka përlllogaritur të ardhurat e personit të lidhur nga ushtrimi i këtij

¹¹ Referuar aktit të gjendjes civile, certifikata familjare nr. {***}, datë 29.03.2023, lëshuar nga Njësia Administrative nr. {***}, Shkodër, subjekti i rivlerësimit për periudhën 03.10.1990 - 23.10.1996, rezulton në gjendje familjare me nënën dhe njërin prej vëllezërimit e saj.

¹² Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 14, datë 09.07.2019.

aktiviteti për periudhën 1997 – 2007, mbi bazën e të dhënave të regjistrit fizik noterial, duke aplikuar një marzh fitimi neto prej 80% të qarkullimit vjetor.

78. Ndërsa për periudhën 2008–2016, Komisioni ka reflektuar të ardhurat sipas të dhënave të konfirmuara nga organet tatimore. Nga analiza e ankimit, rezulton se subjekti nuk ka ngritur pretendime lidhur me metodologjinë e ndjekur për periudhën 1997–1998 dhe as lidhur me nivelin e fitimit të konsideruar për këtë periudhë, por vetëm për periudhën 2008–2016. Për rrjedhojë, pretendimet e ngritura lidhur me të ardhurat nga noteria, nuk ndikojnë në analizën financiare për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 76 m² në vitin 1998, por do të trajtohen në kuadër të shkaqeve të ankimit që lidhen me analizat financiare të viteve 2008, 2010 dhe 2011.
79. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga pensioni familjar, në vlerën 71.394 lekë, për periudhën 1992-1996, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka vlerësuar se këto të ardhura kanë qenë të destinuara për përbalimin e nevojave të të gjithë familjes së subjektit dhe, për shkak të vlerës së tyre të kufizuar në raport me balancën negative të konstatuar, nuk duhet të reflektohen në analizën financiare.
80. Referuar dokumentacionit të administruar, trupi gjykues konstaton se subjekti ka paraqitur vërtetimin e ISSH-*{***}*¹³, sipas të cilit familja e Ç. Gj. B., me anëtarin në ngarkim I. B., është trajtuar me pension familjar për periudhën 01.09.1992 -30.08.1996, në shumën totale 71.391 lekë. Duke pasur parasysh destinacionin familjar të këtyre të ardhurave, periudhën e gjatë kohore gjatë së cilës janë përfitur dhe raportin e tyre me balancën negative të konstatuar, trupi gjykues vlerëson se ato nuk sjellin ndikim domethënës në analizën financiare të kryer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.
81. Veç sa më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kushtet e paqartësisë lidhur me destinacionin e shumës prej 1.350.000 lekësh të përfitur nga shitja e apartamentit në vitin 1997, i ka kërkuar subjektit sqarime edhe në lidhje me krijimin e dy depozitave bankare, konkretisht depozitës në shumën 2.360.000 lekë¹⁴, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 me burim kursimet e vajzërisë dhe të bashkëshortit, si dhe depozitës në shumën 460.000 lekë, të deklaruar me burim kursimet e bashkëshortit.

¹³ Vërtetimi nr. *{***}* prot., datë 29.03.2023, është lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega *{***}*.

¹⁴ Sipas shkresës së Raiffeisen Bank, datë 02.02.2006, administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se: (i) Izabela C. Barbullushi ka depozitë kursimi (dyemërore dhe në emër të K. L. R.) në lekë, pranë Degës *{***}*, me gjendje llogarie në datën 31.12.2003, në shumën 2.362.768 lekë; (ii) K. L. R. ka depozitë kursimi në lekë, pranë Degës *{***}*, me gjendje llogarie në datën 31.12.2003, në shumën 490.295 lekë. Në këtë shkresë sqarohet se informacioni i mëparshëm nuk ka qenë i plotë për shkak të problemeve të sistemit informativ të Bankës së Kursimeve, aktualisht Raiffeisen Bank.

Raiffeisen Bank, nëpërmjet shkresës nr. *{***}* prot., datë 1.2.2023, konfirmon se personi i lidhur K. R. ka pasur të hapur një llogari kursimi më datë 01.02.2000, në shumën 400.000 lekë dhe se kjo shumë, për vitet në vijim, është riinvestuar dhe ka përfitur interesa bankarë, deri në tërheqjen e saj të plotë më datë 02.03.2005, në shumën 561.426 lekë. Konstatohet se në momentin e dorëzimit të deklaratës fillestare të pasurisë në vitin 2003, në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur ka qenë e investuar shuma 2.227.449 lekë dhe 490.295 lekë, ndërsa në periudhën 2004–2016, subjekti dhe personi i lidhur kanë përfitur interesa në vlerën 1.587.631 lekë, të cilat janë akumuluar mbi investimin fillestar dhe në momentin e plotësimit të deklaratës vetting, gjendja në llogaritë bankare – depozitë në Raiffeisen Bank, të evidentuar si më sipër, rezulton në total në shumën 3.760.408 lekë.

82. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me periudhën, historikun dhe burimet e krijimit të këtyre depozitave, duke lënë të paqartë destinacionin e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 1997. Kjo rrethanë vlerësohet nga trupi gjykues në funksion të analizës së besueshmërisë dhe plotësisë së shpjegimeve të subjektit lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.
83. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në datën 03.08.1996. Për rrjedhojë, shuma prej 1.300.000 lekësh, e përfitur nga shitja e këtij apartamenti në datën 07.06.1997, nuk mund të konsiderohet burim i ligjshëm krijimi për apartamentin objekt shqyrtimi.
84. Nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale prej (-) 2.170.854 lekësh¹⁵ për periudhën 1991 - 15.12.1998. Kjo situatë i vendos subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 76 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- *Në lidhje me pasurinë “njësi dyqan”, me sipërfaqe 34,5 m², në Shkodër:*
85. Lidhur me shkakun e ankimit, me të cilin subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
86. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni¹⁶ ka arritur në përfundimin se pagesa e kësaj të parë në shumën 3.000.000 lekë, është kryer në datën 19.02.2008, në përputhje me parashikimet e aktmarrëveshjes së kësaj date. Sipas Komisionit, edhe pas rishikimit të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar këtë pagesë, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 2.905.255 lekë, sipas rezultateve të hetimit të njoftuara subjektit.
87. Komisioni ka vlerësuar gjithashtu se subjekti nuk ka kryer asnjë deklarim në deklaratat periodike vjetore lidhur me këtë pasuri dhe pagesat e kryera për blerjen e saj që nga viti 2008. Pretendimi i subjektit se nuk ka pasur dijeni për këtë transaksion, pasi me blerjen është marrë bashkëshorti dhe pasuria nuk është përdorur, është çmuar si i pamjaftueshëm për të justifikuar mungesën e deklarimeve, për sa kohë deklarimi i pasurive dhe interesave privatë të subjektit dhe personit të lidhur përbën detyrim ligjor, ndërsa deklaratat periodike, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë një nga mjetet e verifikimit të pasurive në procesin e rivlerësimit.

¹⁵ Në kushtet kur Komisioni në vendim ka vlerësuar se subjekti, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit dhe në provat e paraqitura prej saj, ka arritur të provojë marrëdhënien e punës së bashkëshortit për periudhën 07.12.1991 – 23.08.1996, si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe më pas si kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Malësisë së Madhe, analiza mbi mundësinë e blerjes së apartamentit në vitin 1998, është shtrirë duke filluar nga viti 1991.

¹⁶ Në paragrafin 60, f. 18-19 të vendimit objekt shqyrtimi.

88. Po ashtu, Komisioni ka evidentuar se mbetet e paqartë arsyeja përse subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri as në DIPP-në e vitit 2014, ndonëse gjatë këtij viti ka kryer deklarime pranë ILDKPKI-së, si dhe në deklaratat periodike të viteve 2015 dhe 2016. Ndonëse, referuar rrethanave konkrete, mosdeklarimi nuk është vlerësuar se ka sjellë fshehje të pasurisë, ai është çmuar se ka vështirësuar verifikimin e kësaj pasurie, të investimeve dhe pagesave të kryera për të, duke i bërë deklaratimet e subjektit të pamjaftueshme në kuptim të ligjit nr. 84/2016.
89. Ky konkluzion është mbështetur nga Komisioni në arsyetimin se: (i) aktmarrëveshja është nënshkruar nga të dyja palët dhe nënshkrimet janë vërtetuar me aktin “Autentifikimi i nënshkrimit” nr. {***} rep., datë 19.02.2008, nga noteri P. Z.; (ii) subjekti ka mbajtur qëndrime kontradiktore lidhur me periudhën e ndërtimit të objektit dhe nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës për pretendimet e saj në lidhje me kohën e përfundimit të tij; (iii) sipas të dhënave të OSHEE-së, kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. {***}, është çelur për herë të parë në datën 31.03.2008, duke treguar se objekti ka qenë i përfunduar në kohën e lidhjes së aktmarrëveshjes, ndërsa dokumentacioni i paraqitur në seancë dëgjimore bie ndesh me informacionin e përftuar nga sistemi ASIG, sipas të cilit objekti rezulton i ndërtuar që në vitin 2007; dhe (iv) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të justifikuar pakësim të likuiditeteve *cash* apo pagesa të kryera për shumën 3.000.000 lekë në vitet 2007, 2008 dhe 2009, ndërsa pretendimi se nuk ka qenë në dijeni për shkak të rolit të bashkëshortit dhe mospërdorimit të pasurisë nuk justifikon mosdeklarimin në deklaratat periodike, veçanërisht kur mungojnë deklarime edhe për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
90. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit dhe pretendon se: (i) aktmarrëveshja e datës 19.02.2008 nuk përbën kontratë përfundimtare shitblerjeje, por është hartuar për të formalizuar një marrëveshje verbale të mëparshme ndërmjet palëve, gjë që, sipas saj, përforcohet edhe nga fakti se dokumenti nuk është përpiluar në formë noteriale, por vetëm janë autentifikuar nënshkrimet e palëve; (ii) deklarimi në aktmarrëveshje se çmimi është likuiduar plotësisht, nuk pasqyron gjendjen reale, pasi pagesat janë kryer me këste gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009; (iii) po ashtu, në vitin 2014 është kryer një pagesë shtesë prej 500.000 lekësh, si pasojë e rritjes së çmimit të kërkuar nga trashëgimtarët e palës shitëse, rrethanë që, sipas saj, provohet nga deklarata noteriale e znj. P. M.; (iv) ndonëse sipas aktmarrëveshjes punimet do të përfundonin në fund të muajit shkurt 2008, objekti është përfunduar në vitin 2015; (v) sipas subjektit, kontrata e furnizimit me energji elektrike në emër të bashkëshortit të saj, pasqyron vetëm ndryshimin e emrit të abonentit nga A. M. në K. R. në vitin 2015 dhe jo përdorimin efektiv të objektit, i cili, sipas saj, nuk është përdorur asnjëherë; (vi) pagesa shtesë prej 500.000 lekësh, e kryer në vitin 2014, është deklaruar në DIPP-në përkatëse nëpërmjet pakësimit të depozitës në Tirana Bank, në përputhje me veprimin bankar dhe deklaratën noteriale të znj. P. M.; dhe (vii) duke pranuar pasaktësitë në deklarime, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i kësaj pasurie lidhet me faktin se ajo dhe bashkëshorti nuk janë bërë pronarë të saj, për shkak të mosmarrëveshjeve me trashëgimtarët e z. A. M. dhe mungesës së kontratës përfundimtare të shitjes. Sipas saj, pasuria është deklaruar në deklaratën *vetting*, janë dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së dhe nuk është konstatuar fshehje pasurie.
91. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të vlerësuar në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor dhe arsyetimin e Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.

92. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Njësi dyqan me sip. 34,5 m², e ndodhur në Shkodër, Z.K. {***}, realizuar aktmarrëveshje, datë 19.02.2008, sipas së cilës është paguar vlera 3.000.000 lekë për periudhën 2007, 2008, 2009; meqenëse shitësi ka vdekur, trashëgimtarja e tij nuk realizoi kontratën, pasi në mënyrë të padrejtë rriti vlerën e çmimit. Paguar në vitin 2014 edhe 500.000 lekë. Mbetur pa u paguar edhe 500.000 lekë. Burimi i fitimit: të ardhura nga puna e të dyve. Paguar 3.500.000 lekë. Pjesa takuese 50%”.
93. Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar aktmarrëveshjen e datës 19.02.2008 dhe as pagesat e kryera në lidhje me këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2008 dhe në deklaratat periodike pasuese.
94. Po kështu, në DIPP-në e vitit 2014, subjekti nuk ka deklaruar pagesën prej 500.000 lekësh të pretenduar si të kryer për këtë pasuri dhe as ekzistencën e ndonjë detyrimi financiar të mbetur në lidhje me të.
95. Sipas aktmarrëveshjes së datës 19.02.2008, z. A. M. dhe z. K. R. kanë rënë dakord për shitjen e një njësie tregtare me sipërfaqe totale 34,5 m², kundrejt çmimit prej 3.000.000 lekësh, shumë e cila deklarohet se është likuiduar plotësisht ndërmjet palëve. Në marrëveshje, parashikohet gjithashtu se punimet ndërtimore do të përfundonin në fund të muajit shkurt 2008 dhe se, pas përmbylljes së dokumentacionit teknik për sipërfaqen ndërtimore, do të realizohej akti përfundimtar i shitjes sipas ligjit. Nënshkrimet e palëve në këtë aktmarrëveshje janë vërtetuar nga noteri P. Z. sipas aktit “Autentifikimi i nënshkrimit” nr. {***} rep., datë 19.02.2008.
96. Referuar deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.10.2014, znj. P. M. deklaroi se është në dijeni të aktmarrëveshjes së lidhur më datë 19.02.2008 ndërmjet bashkëshortit të saj të ndjerë dhe z. K. R., për shitjen e njësisë tregtare me sipërfaqe 34,5 m², në vlerën totale prej 3.000.000 lekësh. Ajo deklaroi më tej se, sipas deklarimeve verbale dhe shkresore të bashkëshortit të saj, kjo shumë është likuiduar plotësisht me këste gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, si dhe se palët ndodheshin në përfundim të procedurave për nënshkrimin e aktit përfundimtar të shitjes, pasi të përmbylleshin detyrimet e mbetura ndërmjet tyre.
97. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së¹⁷, lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar fillimisht se paraqitja e aktmarrëveshjes së datës 19.02.2008 është bërë me iniciativën dhe vullnetin e saj, duke qenë e ndërgjegjshme për pasaktësinë e kryer në deklarime. Ajo ka deklaruar se ka marrë dijeni për ekzistencën e kësaj pasurie në vitin 2010 dhe se mosdeklarimi lidhet edhe me faktin se ajo dhe bashkëshorti nuk janë bërë ende pronarë të saj.
98. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se në procesverbalin e datës 09.01.2009¹⁸, pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash* në vitet 2007 dhe 2008, të cilat, sipas saj, kanë shërbyer për pagesat e lidhura me blerjen e njësisë tregtare. Sipas deklarimeve të saj, pagesat e kryera gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, në shumën totale 3.000.000 lekë, kanë pasur si burim të ardhurat e përfituara nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Ajo ka shtuar se, pas vitit 2010, nuk janë kryer pagesa të tjera, pasi bashkëshortja e shtetasit A. M. ka kërkuar edhe 1.000.000 lekë shtesë, duke rritur çmimin dhe sipërfaqen e njësisë në kundërshtim me marrëveshjen fillestare.

¹⁷ Shih procesverbalet e datave 18.09.2014 dhe 3.10.2014 të ILDKPKI-së.

¹⁸ Në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit është thirrur nga ILDKPKI-ja për të dhënë sqarime në lidhje me DIPP-2007.

99. Nga aktet e administruara nga ILDKPKI-ja¹⁹, rezulton se pasuria nr. {***}, Z.K. {***}, e llojit “njësi tregtare”, me sipërfaqe 44,75 m², figuron në bashkëpronësi të shtetasve P., M., A. dhe A. M. ASHK Shkodër nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit apo të bashkëshortit të saj.
100. Sipas shkresës së Furnizuesit të Shërbimit Universal (në vijim “FSHU”)²⁰, rezulton se kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. {***}, figuron në emër të z. K. R. dhe është çelur në datën 31.03.2008. Në rubrikën *Shënime të vjetra*, evidentohet shënimi: “Emri A. M. në K. R. {***} dt. 27.03.2015. *A qëndro/vulokset {***}. I.C, {***}*”.
101. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka nënshkruar një aktmarrëveshje, të vërtetuar me aktin “Autentifikimi i nënshkrimit” nr. {***} rep., datë 19.02.2008, për blerjen e një “njësie dyqan” të ndodhur në Shkodër, me sipërfaqe totale 34,5 m², kundrejt çmimit prej 3.000.000 lekësh, shumë e cila në aktmarrëveshje deklarohet si e likuiduar plotësisht. Sipas subjektit, në fakt kjo shumë është shlyer pjesërisht gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, rrethanë që, sipas saj, konfirmohet edhe nga deklaratimet e bashkëshortes së pronarit të ndjerë.
102. Subjekti ka shpjeguar se nevoja për lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje, ka lindur për shkak se personi që po kryente punimet e ndërtimit, kishte nevojë për burime financiare për përfundimin e objektit, ndërsa bashkëshorti i saj do të vijonte me likuidimin e shumave në një moment të mëvonshëm, gjë që, sipas saj, ka ndodhur deri në vitin 2009. Ajo ka shtuar se, ndonëse vlera është likuiduar, akti përfundimtar i shitjes nuk është realizuar për shkak të mosmarrëveshjeve me bashkëshorten e pronarit të ndjerë, e cila ka kërkuar rritjen e çmimit dhe të sipërfaqes së njësisë në kundërshtim me marrëveshjen fillestare. Më tej, subjekti ka deklaruar se më datë 02.10.2014, ka kryer një pagesë shtesë në shumën 500.000 lekë, të cilën pretendon se e ka deklaruar në deklaratën periodike përkatëse, me burim të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit.
103. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me mospërputhjet në deklarime mbi mënyrën e likuidimit të shumës 3.500.000 lekë, si dhe të paraqiste informacion dhe dokumentacion në lidhje me origjinën, statusin juridik, pronarin aktual dhe përdorimin e kësaj pasurie.
104. Në përgjigje të këtyre kërkesave, subjekti deklaroi se pasuria vijon të figurojë në emër të znj. P. M. dhe se ajo dhe bashkëshorti i saj nuk e kanë përdorur dhe as mobiluar ndonjëherë këtë ambient, duke paguar, sipas saj, vetëm detyrimet për energjinë elektrike që prej vitit 2014. Subjekti pretendoi se objekti nuk i është dorëzuar për shkak të ekzistencës së një detyrimi të papaguar në shumën 4.629 euro.
105. Ndërkohë, subjekti nuk dha shpjegime bindëse në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve të saj për momentin e marrjes dijeni mbi ekzistencën e aktmarrëveshjes, duke këmbëngulur në qëndrimin se kishte marrë dijeni për këtë transaksion vetëm në vitin 2010, pas vdekjes së z. A.

¹⁹ Sipas procesverbalit të datës 03.10.2014, janë administruar aktmarrëveshje për blerjen e njësisë 34,5 m², deklaratë noteriale datë 02.10.2014, certifikatë për vërtetim pronësie dhe planimetri për njësinë me sipërfaqe 44,75 m².

²⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

M.. Bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti: (i) aktmarrëveshjen e datës 19.02.2008; (ii) planimetrinë; (iii) një fletëllogaritje të hartuar me shkrim dore nga ekonomistja e znj. P. M.; (iv) deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.10.2014; si dhe (v) faturë të OSSHE-së dhe librezën nr. {***}, në emër të z. K. R..

106. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova lidhur me konstatimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e shumës prej 3.000.000 lekësh, të konsideruar si të kryer në datën 19.02.2008, duke rezultuar me balancë negative në shumën (-) 2.905.255 lekë.
107. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim të shprehur edhe në ankim, duke kundërshtuar përfundimin e Komisionit se shuma prej 3.000.000 lekësh duhet të konsiderohet e paguar në datën e lidhjes së aktmarrëveshjes. Sipas saj, kjo shumë është likuiduar në mënyrë të pjesshme gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, në vlerën 1.000.000 lekë për secilin vit.
108. Megjithatë, me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti prova shkresore në mbështetje të këtij pretendimi. Vetëm gjatë seancës dëgjimore të datës 12.04.2023, ajo depozitoi disa dokumente që lidhen me praktikën e lejes së ndërtimit dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit²¹.
109. Në analizë të fakteve dhe provave të administruara, si dhe në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
110. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton e provuar ekzistenca e aktmarrëveshjes së datës 19.02.2008, nëpërmjet së cilës z. A. M. dhe z. K. R. kanë rënë dakord për shitjen e pasurisë objekt shqyrtimi kundrejt çmimit total prej 3.000.000 lekësh, shumë e cila, në vetë përmbajtjen e këtij akti, deklarohet si e likuiduar plotësisht ndërmjet palëve.
111. Ky fakt mbështetet jo vetëm në përmbajtjen e aktmarrëveshjes, nënshkrimet e së cilës janë vërtetuar nga noteri P. Z. me aktin “Autentifikimi i nënshkrimit” nr. {***} rep., datë 19.02.2008, por edhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.10.2014, të znj. P. M., e cila konfirmon likuidimin e shumës prej 3.000.000 lekësh, ndonëse deklaron se kjo shumë është shlyer me këste gjatë viteve 2007-2009.
112. Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as aktmarrëveshjen dhe as pagesat e kryera në lidhje me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet që rridhnin nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Referuar nenit 4 të këtij ligji²²,

²¹ Kopje të praktikës së lejes së ndërtimit nr. {***} prot., sipas shkresës nr. {***} prot., datë 07.04.2023, të Bashkisë {***}; leje ndërtimi nr. {***} prot., për z. A. M. për objektin dyqane 2 kate; leje përdorimi nr. {***} prot., datë 21.6.2013, për objektin 2 kate dyqane, certifikatë pronësie, datë 28.6.2013, sipas së cilës pasuria ndërtesë me 2 kate, me sip. 4300 m² ndërtesë, figuron në pronësi të trashëgimtarëve (bashkëpronarëve M.); kartela e pasurisë nr. {***} me shënimet se kjo pasuri është ngritur mbi pasuritë nr. {***}, {***}, {***}, {***} etj.; si dhe dokumentacion hartografik.

²² Në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet: “Subjektet deklaruese duhet të deklarojnë detyrimet financiare të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor

subjektet e detyruara për deklarim duhet të pasqyrojnë detyrimet financiare dhe interesat privatë të krijuar gjatë periudhës deklaruese.

113. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se aktmarrëveshja e lidhur në muajin shkurt 2008 dhe pagesa prej 3.000.000 lekësh, e deklaruar në të si e likuiduar plotësisht, përbënin rrethana që duhej të deklaroheshin në deklaratën periodike të vitit 2008. Mosdeklarimi i tyre jo vetëm që përfaqëson mospërbushje të detyrimeve ligjore të deklarimit, por ka vështirësuar edhe verifikimin e pretendimeve të mëvonshme të subjektit se pagesa është kryer me këste gjatë viteve 2007-2009, pasi mungojnë deklarime të kohës që do të mundësonin kontrollin e vërtetësisë së tyre.
114. Përkundër pretendimeve të subjektit se pagesat janë kryer me këste gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009, trupi gjykues konstaton se vetë aktmarrëveshja e datës 19.02.2008 nuk përmban asnjë parashikim për shlyerje të pjesshme të çmimit, për pagesa me këste apo për ekzistencën e detyrimeve të papaguara. Përkundrazi, nga përmbajtja e saj, rezulton se çmimi prej 3.000.000 lekësh është likuiduar plotësisht në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes.
115. Në vlerësim të deklarimeve të subjektit pranë ILDKPKI-së, trupi gjykues konstaton se ato paraqiten kontradiktore. Në procesverbalin e datës 18.09.2014, subjekti ka deklaruar se ka marrë dijëni për ekzistencën e aktmarrëveshjes në vitin 2010, ndërsa në procesverbalin e datës 03.10.2014, ka deklaruar se pagesat për këtë objekt janë kryer gjatë viteve 2007–2009 dhe se që prej vitit 2010 nuk janë bërë më pagesa të tjera.
116. Po kështu, subjekti ka pretenduar se pakësimet e likuiditeteve *cash* të deklaruara pranë ILDKPKI-së në vitet 2007 dhe 2008 kanë shërbyer për financimin e kësaj pasurie. Megjithatë, këto deklarime nuk harmonizohen me pretendimin se ajo ka marrë dijëni për ekzistencën e aktmarrëveshjes vetëm në vitin 2010. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk rezultojnë koherente dhe nuk arrijnë nivelin e të shpjeguarit bindshëm të rrethanave të krijimit të kësaj pasurie.
117. Nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2007, rezulton se subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 1.000.000 lekë dhe pakësim të saj në vlerën 200.000 lekë, pa deklaruar destinacionin e përdorimit të këtyre shumave. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në shumën 1.000.000 lekë, të përdorur për blerje automjeti, por nuk rezulton të ketë deklaruar pagesa të kryera për financimin e pasurisë objekt shqyrtimi.
118. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se pagesat për njësinë tregtare janë kryer gjatë viteve 2007-2009, mbetet deklarativ dhe i pambështetur në prova të kohës. Përveç mungesës së deklarimeve përkatëse, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër të përshtatshëm për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit lidhur me momentin e kryerjes së pagesës prej 3.000.000 lekësh.
119. Trupi gjykues konstaton se, me parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti ka paraqitur për herë të parë tri mandatpagesa, të cilat pretendon se provojnë pagesat e kryera gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009 për blerjen e njësisë tregtare. Subjekti ka pretenduar se ndodhej në pamundësi

të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.

për t'i siguruar dhe paraqitur më herët këto dokumente për shkak të mosmarrëveshjeve dhe mungesës së bashkëpunimit nga trashëgimtarët e z. A. M..

120. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit lidhur me administrimin e provave të reja në apel, sipas të cilit pala që kërkon marrjen në konsideratë të tyre, duhet të provojë pamundësinë objektive për paraqitjen e këtyre provave në fazat e mëparshme të procesit. Në rastin konkret, subjekti nuk ka arritur të provojë rrethana të tilla që të justifikojnë paraqitjen e vonuar të këtyre dokumenteve, për rrjedhojë ato nuk mund të ndikojnë në përmbysjen e konkluzioneve të arritura mbi bazën e provave të administruara rregullisht gjatë procesit.
121. Lidhur me pagesën prej 500.000 lekësh²³, e pretenduar si e kryer në vitin 2014, trupi gjykues konstaton se në DIPP-në e këtij viti, subjekti ka deklaruar pakësim të depozitës në Tirana Bank në shumën 500.000 lekë, por nuk ka deklaruar shprehimisht kryerjen e kësaj pagese për blerjen e njësisë tregtare dhe as ekzistencën e një detyrimi financiar në lidhje me këtë pasuri.
122. Nga ana tjetër, referuar deklaramëve të subjektit në ILDKPKI, deklaratës *vetting*, deklaratës noteriale të znj. P. M. dhe faktit që data e kësaj deklarate përputhet me datën e tërheqjes së shumës 500.000 lekë nga Tirana Bank, trupi gjykues vlerëson se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të konsideruar të provuar kryerjen e kësaj pagese në favor të pasurisë objekt shqyrtimi. Për rrjedhojë, pavarësisht pasaktësisë në deklarim, kjo shumë duhet të konsiderohet si shpenzim i kryer në vitin 2014, për realizimin e blerjes së njësisë tregtare.
123. Në mbështetje të pretendimit se pagesa nuk është kryer në momentin e lidhjes së aktmarrëveshjes, subjekti ka pretenduar se punimet e objektit kanë përfunduar vetëm në vitin 2015. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se, sipas vetë aktmarrëveshjes së datës 19.02.2008, punimet ndërtimore parashikoheshin të përfundonin brenda muajit shkurt 2008.
124. Nga dokumentacioni i paraqitur në Komision, rezulton se leja e ndërtimit është lëshuar më datë 10.06.2006, ndërsa, sipas aktit të kolaudimit, punimet janë deklaruar të përfunduara më datë 19.02.2008. Leja e përdorimit është lëshuar më datë 21.06.2013, ndërsa, sipas certifikatës së pronësisë, pasuria ku ndodhet njësia tregtare është regjistruar në emër të trashëgimtarëve të z. A. M. më datë 28.06.2013. Po kështu, kontrata e furnizimit me energji elektrike në lidhje me këtë pasuri²⁴, rezulton të jetë çelur që në datën 31.03.2008.
125. Në vlerësim të këtyre provave në tërësinë e tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se objekti ka qenë i përfunduar dhe funksional që në periudhën e lidhjes së aktmarrëveshjes, ndërsa pretendimi i subjektit se punimet kanë përfunduar në vitin 2015, rezulton i pabazuar.

²³ Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, përveç pagesës 3.000.000 lekë, ka deklaruar edhe kryerjen e pagesës në shumën 500.000 lekë në vitin 2014, si dhe ka deklaruar se mbeten për t'u paguar edhe 500.000 lekë. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur mandat tërheqjeje bankare, datë 02.10.2014, të Tirana Bank, në shumën 500.000 lekë, me përshkrimin: "Izabela Radovani Pagë Shkodër", mandat arkëtimi nr. {***}, datë 2.10.2014, K. R. , shuma 500.000 lekë : 140 = 3571 euro, mandat i cili nuk paraqet asnjë të dhënë se kujt i është adresuar dhe kush e ka pranuar atë, si dhe qëllimin e pagesës.

²⁴ Informacion nga shkresa nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

126. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 3.000.000 lekësh duhet të konsiderohet e paguar në datën 19.02.2008, në përputhje me përmbajtjen e aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve.
127. Ndërsa, sa i takon shumës prej 500.000 lekësh, e deklaruar si e paguar në datën 02.10.2014²⁵, megjithëse nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 si pagesë e kryer për pasurinë “njësi dyqan”, referuar deklaramëve të subjektit, deklaratës noteriale të znj. P. M. dhe dokumentacionit bankar të administruar, trupi gjykues çmon se ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të konsideruar të provuar kryerjen e kësaj pagese në favor të realizimit të blerjes së kësaj pasurie.
128. Për rrjedhojë, në lidhje me pasurinë “njësi dyqan”, vlera totale e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur konsiderohet 3.500.000 lekë, nga të cilat 3.000.000 lekë janë paguar në vitin 2008 dhe 500.000 lekë në vitin 2014.
129. Nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se, edhe duke marrë në konsideratë pagesën prej 500.000 lekësh në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 2.905.255 lekë për financimin e pasurisë “njësi dyqan” me sipërfaqe 34,5 m², të ndodhur në Shkodër.
130. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
- *Në lidhje me analizën financiare:*
131. Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhat 1996-2003 dhe 2004-2016, duke konstatuar balanca negative përkatësisht: (i) për periudhën 1996-2003, në shumën (-) 380.700 lekë; (ii) për vitin 2008, në shumën (-) 1.534.384 lekë; (iii) për vitin 2010, në shumën (-) 12.318 lekë; (iv) për vitin 2011, në shumën (-) 228.121 lekë. Në total, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 2.155.523 lekë.
132. Subjekti i rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, pretendon në ankim se analiza financiare duhet të rishikohet, duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat dhe likuiditetet e provuara me dokumentacion. Konkretisht, ajo kërkon që në analizë të reflektohen këto korrigjime: (i) për vitin 2004, gjendja *cash* duhet të konsiderohet në shumën 700.000 lekë, e përbërë nga 400.000 lekë në favor të bashkëshortit dhe 300.000 lekë në favor të subjektit, ndërkohë që Komisioni ka reflektuar vetëm shumën 300.000 lekë; (ii) për vitin 2005, gjendja e likuiditeteve në bankë nuk ka pësuar ndryshim, ndërsa Komisioni, sipas subjektit, gabimisht ka pasqyruar depozitën në shumën 560.000 lekë pranë Raiffeisen Bank; dhe (iii) për vitin 2006 duhet të reflektohet ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë, pasi shuma prej 560.000 lekësh është tërhequr

²⁵ Deklarata e znj. P. M. dhe pagesa prej 500.000 lekësh është kryer një ditë para paraqitjes së subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, më datë 03.10.2014, ku subjekti është thirrur për të dhënë sqarime në lidhje me aktmarrëveshjen e vitit 2008.

nga depozita, ndërkohë që kjo shumë, sipas subjektit, nuk është pasqyruar nga Komisioni si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar.

133. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, arsyetimin e vendimit dhe dokumentacionin mbështetës, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon.
134. Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar: (i) depozitë të hapur në vitin 1995, në shumën 2.360.000 lekë pranë Bankës së Kursimeve, me burim kursimet personale dhe ato të bashkëshortit; dhe (ii) depozitë të hapur më datë 01.03.2001, në shumën 460.000 lekë, me burim kursimet e bashkëshortit.
135. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: (i) “Të holla (lekë) 300.000 (treqind mijë)”, me pjesë takuese $\frac{1}{2}$ dhe datë krijimi 07.03.1995; (ii) “Të holla (lekë), në favor të bashkëshortit, shuma 400.000 (katërqind mijë)”, me datë krijimi 01.03.2001; si dhe (iii) në rubrikën “Informacion konfidencial”, ekzistencën e një depozite bankare pranë Raiffeisen Bank.
136. Referuar këtyre deklaramëve, lidhur me shumën prej 400.000 lekësh, të krijuar më datë 01.03.2001 dhe të pretenduar nga subjekti si pjesë e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar për vitin 2004, trupi gjykues vëren se data e krijimit të kësaj shume, përkon me datën e krijimit të depozitës bankare të deklaruar më datë 01.03.2001, në shumën 460.000 lekë. Në këto kushte, duke u bazuar në mënyrën e deklarimit të subjektit ndër vite, rezulton se kjo shumë i referohet më tepër gjendjes së depozitës bankare dhe jo një gjendjeje *cash* të mbajtur jashtë sistemit bankar.
137. Megjithatë, edhe në rast se shuma prej 400.000 lekësh do të reflektohej në analizën financiare sipas pretendimit të subjektit, si gjendje *cash* për vitin 2004, rezultati i analizës nuk do të ndryshonte në thelb, pasi për këtë vit subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me balancë pozitive në shumën 1.523.533 lekë. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk sjell ndikim në rezultatin përfundimtar të analizës financiare.
138. Në lidhje me pretendimin e subjektit se gjendja e likuiditeteve në bankë, për vitin 2005, nuk ka pësuar ndryshim dhe se Komisioni gabimisht ka pasqyruar në analizë depozitën në shumën 560.000 lekë pranë Raiffeisen Bank, trupi gjykues vëren se në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: (i) interesa nga kursimet dhe depozitat deri më datë 31.12.2005, në vlerën 26.286 lekë, si dhe vlerën totale të depozitës në shumën 587.712 lekë, me pjesë takuese 50%; dhe (ii) kursime të përbashkëta në shumën 600.000 lekë, me pjesë takuese 50%.
139. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: (i) tërheqje nga depozita bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të bashkëshortit, në shumën 560.000 lekë; dhe (ii) gjendje *cash* në shtëpi në shumën 1.200.000 lekë.
140. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezulton se tërheqja e shumës prej 560.000 lekësh është kryer më datë 02.03.2005. Megjithatë, subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 pakësimin e kësaj depozite, por e ka pasqyruar atë si pjesë të gjendjes së llogarisë bankare deri më 31.12.2005. Vetëm në DIPP-në e vitit 2006, të dorëzuar më datë 26.03.2007, subjekti ka deklaruar pakësimin e depozitës në shumën 560.000 lekë dhe rritjen përkatëse të gjendjes *cash* në shtëpi.

141. Nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, rezulton se gjendjet *cash* janë reflektuar sipas deklarimeve të subjektit, ndërsa lëvizjet në depozitën bankare janë pasqyruar sipas dokumentacionit bankar objektiv. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka ndjekur një metodologji të bazuar në prova, duke siguruar një pasqyrim kronologjik të saktë të lëvizjeve të likuiditeteve. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për pasaktësi në trajtimin e kësaj shume, rezultojnë të pabazuara.
142. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim një version të rishikuar të analizës financiare, ku, përveç pretendimeve të trajtuara më sipër në këtë vendim, ka kërkuar edhe ripërlllogaritjen e të ardhurave të bashkëshortit nga ushtrimi i aktivitetit privat si noter për periudhën 2008–2016. Sipas subjektit, këto të ardhura duhet të përcaktohen mbi bazën e të dhënave të regjistrave noterialë dhe jo sipas të dhënave zyrtare të konfirmuara nga administrata tatimore.
143. Trupi gjykues e ka analizuar këtë pretendim në vijim në këtë vendim, në kuadër të analizës së metodologjisë së ndjekur nga Komisioni për përllogaritjen e të ardhurave të personit të lidhur nga ushtrimi i aktivitetit noterial.
144. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, në mungesë të informacionit të plotë mbi fitimin neto të realizuar nga personi i lidhur, ka përllogaritur të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit si noter për periudhën 1997–2007, duke u bazuar në të dhënat e regjistrave fizikë noterialë dhe duke aplikuar një *marzh* fitimi neto prej 80% të qarkullimit vjetor të realizuar gjatë kësaj periudhe. Ndërsa për periudhën 2008–2016, Komisioni ka reflektuar në analizën financiare të ardhurat e konfirmuara nga organet tatimore, sipas vetëdeklarimeve të personit të lidhur në cilësinë e personit fizik.
145. Subjekti i rivlerësimit, si në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, ashtu edhe në ankim, pretendon se edhe për periudhën 2008-2016, duhet të zbatohet e njëjta metodologji e ndjekur nga Komisioni për periudhën 1997–2007, duke aplikuar *marzhin* e fitimit *neto* prej 80% mbi qarkullimin e realizuar, bazuar në të dhënat e pasqyruara në regjistrat noterialë.
146. Nga verifikimi i akteve të administruara në dosje, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura totale të bashkëshortit në shumën 25.507.120 lekë, të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit si noter publik për periudhën korrik 1997 – janar 2017. Në funksion të provimit të këtij aktiviteti, subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me ushtrimin e profesionit dhe regjistrimin në organet tatimore, ekstrakte nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe informacion të dërguar nga DRT {***} në lidhje me qarkullimin vjetor dhe fitimet e deklaruara nga personi i lidhur si person fizik.
147. Nëpërmjet komunikimit elektronik me Komisionin, DRT {***} ka konfirmuar mungesën e informacionit të plotë për disa vite tatimore, për shkak të mungesës së arkivit dhe lëvizjeve të shpeshta të personelit, duke përcjellë vetëm një pjesë të të dhënave në lidhje me tatimfitimin e thjeshtuar të paguar nga personi fizik për vitet 1997, 1999 dhe 2001, si dhe qarkullimin e realizuar për vitet 2002 dhe 2003. Në këto kushte, me kërkesë të Komisionit, subjekti ka paraqitur të gjithë regjistrat fizikë të akteve dhe veprimeve noteriale të z. K. R..
148. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni ka përllogaritur qarkullimin e realizuar nga aktiviteti noterial për periudhën 05.09.1997 – 15.12.1998, në shumën 635.700 lekë dhe, në mungesë të të dhënave të plota mbi fitimin *neto*, ka aplikuar një *marzh* fitimi prej 80% mbi qarkullimin,

duke përfshirë në analizën financiare të ardhura të vlerësuara në shumën 508.560 lekë. E njëjta metodologji është ndjekur edhe për periudhën 15.12.1998 – 31.12.2007.

149. Në vijim, DRT {***}²⁶ ka informuar se disponon të dhëna për subjektin tatimpagues K. R., noter, për periudhën 2008-2016, megjithëse jo të plota për të gjitha vitet. Konkretisht, ky institucion nuk ka konfirmuar fitimin e realizuar për të gjithë periudhën, ndërsa për vitin 2009 ka deklaruar se qarkullimi dhe fitimi kanë qenë zero. Për vitin 2013, është konfirmuar vetëm qarkullimi i realizuar.
150. Nga kontrolli i ushtruar mbi analizën financiare, rezulton se, për periudhën 01.01.2008 – 31.12.2016, Komisioni ka reflektuar të ardhurat e konfirmuara nga administrata tatimore. Për vitin 2009, në mungesë të të dhënave të plota, Komisioni ka marrë në konsideratë deklarin e subjektit në DIPP-në përkatëse, duke vlerësuar se ai paraqitej në raport proporcional me fitimin e vitit paraardhës. Ndërsa për vitin 2013, në kushtet kur ishte konfirmuar vetëm qarkullimi, fitimi është përlllogaritur në raport proporcional me fitimin e realizuar në vitin 2014.
151. Në kushtet kur, për periudhën 2008 – 2016, ekzistojnë të dhëna të verifikuara nga administrata tatimore, të cilat pasqyrojnë qarkullimin, fitimin dhe pagesën e detyrimeve përkatëse, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e personit të lidhur duhet të reflektohen në analizën financiare mbi bazën e këtyre të dhënave zyrtare. Referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, deklarinmet dhe konfirmimet e organeve tatimore përbëjnë burimin parësor të vlerësimit të të ardhurave të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit privat si person fizik. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se, për këtë periudhë, duhet të aplikohet *marzhi* i fitimit *neto* prej 80% mbi qarkullimin, vlerësohet i pabazuar.
152. Bazuar në analizën e mësipërme dhe në kontrollin e ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit për periudhën 1996-2016, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit rezultojnë të pabazuara, me përjashtim të pretendimit lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortit për periudhën 1994-1996, të trajtuar më sipër në këtë vendim.
153. Këto të ardhura ndikojnë në analizën financiare që lidhet me mundësinë e krijimit të apartamenteve të blera në vitet 1996 dhe 1998, me një diferencë prej 4.000 lekësh, e cila është reflektuar përkatësisht në analizën financiare për periudhën 1996-2003, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit.
154. Në përfundim të analizës financiare të kryer për periudhat 1996-2003 dhe 2004-2016, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve përkatëse. Konkretisht, rezultojnë balanca negative: (i) për periudhën 1996–2003, në shumën (-) 380.700 lekë; (ii) për vitin 2008, në shumën (-) 1.534.384 lekë; (iii) për vitin 2010, në shumën (-) 12.318 lekë; dhe (iv) për vitin 2011, në shumën (-) 228.121 lekë.
155. Për rrjedhojë, nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale (-) 2.155.523 lekë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

²⁶ Shkresa kthim përgjigje e DRT {***} nr. {***} prot., datë 30.01.2023.

➤ *Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit:*

156. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionin e Komisionit për vlerësimin e rrethanave të përfshirjes së saj në trajtimin e dy çështjeve civile, përkatësisht çështjes nr. {***}, datë 09.03.2011, dhe çështjes nr. {***}, datë 08.11.2012, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në shqyrtimin e tyre në kushtet e konfliktit të interesit.
157. Duke iu referuar trajtimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të dy çështjeve civile të sipërcituara, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka ushtruar funksionin gjyqësor në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të ekzistencës së një marrëdhënieje konfliktuale me palën e paditur P. M.. Sipas Komisionit, referuar vetëdeklarimeve të subjektit dhe rrethanave të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, subjekti dhe personi i lidhur kanë qenë në një marrëdhënie juridiko-civile të papërfunduar me këtë shtetase gjatë periudhës kur janë shqyrtuar çështjet në fjalë, ndërkohë që bashkëshorti i subjektit ka pasur ndërveprime profesionale ndër vite me shoqërinë “{***}” ShPK, administratore e së cilës ishte znj. P. M..
158. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konstatim në ankim, duke pretenduar se: (i) Komisioni ka evidentuar në dëm të figurës së saj një fakt të paprovuar, i cili nuk mbështetet as në prova shkresore dhe as në deklarime konkrete të individëve, ndërsa sjellja e saj nuk ka vënë në rrezik integritetin si gjyqtare dhe as nuk ka cenuar besimin e publikut te drejtësia e vendimmarrjes apo te pushteti gjyqësor në tërësi; për rrjedhojë, një gjetje e tillë nuk mund të jetë përcaktuese për aplikimin e masës së shkarkimit; dhe (ii) në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe me jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni ka përdorur konfliktin e interesit si argument në funksion të masës ekstreme të shkarkimit, ndonëse në raste të tjera situata të ngjashme nuk janë konsideruar pengesë për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit²⁷.
159. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, referuar akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se në çështjen civile nr. {***}, datë 09.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër²⁸, me gjyqtare subjektin e rivlerësimit, znj. Izabela Radovani, shtetasi Gj. M. ka ngritur padi ndaj trashëgimtarëve ligjorë të z. A. M., me objekt shpërblimin e dëmit nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.
160. Nga aktet e administruara, rezulton se seanca përgatitore e datës 25.02.2011, është shtyrë, pasi gjykata ka konstatuar të meta të padisë dhe i ka kërkuar paditësit plotësimin e tyre, konkretisht përcaktimin e saktë të emrit dhe adresës së palës së paditur. Më pas, paditësi ka kërkuar kthimin e akteve, duke pretenduar se nuk kishte mundur të plotësonte të metat e konstatuara. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës, ka vendosur kthimin e padisë së bashku me aktet bashkëlidhur palës paditëse, vendim i cili duhej t'u komunikohet trashëgimtarëve ligjorë të z. A. M..

²⁷ Subjekti i rivlerësimit referon vendimet nr. {***}, datë 21.06.2018, nr. {***}, datë 10.07.2020 dhe nr. {***}, datë 21.07.2020 të Komisionit.

²⁸ Vendimin nr. {***}, datë 09.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vënë në dispozicion të Komisionit nëpërmjet shkresës nr. {***}, datë 09.09.2022.

161. Nisur nga këto rrethana, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit, pasi kishte qenë në një marrëdhënie juridiko-civile me palën e paditur, konkretisht me znj. P. M., trashëgimtare ligjore e z. A. M.. Për këtë arsye, sipas Komisionit, subjekti duhej të kishte kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, gjë që nuk rezultoi ta ketë bërë, duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Në kuadër të rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkuua të paraqiste shpjegime në lidhje me këtë konstatim.
162. Me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se ajo nuk e ka gjykuar në themel këtë çështje dhe se, në përputhje me nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata kishte detyrimin të identifikonte më parë saktë palët ndërgjyqëse dhe vetëm më pas të vlerësonte ekzistencën e shkaqeve të heqjes dorë sipas nenit 72 të këtij Kodi.
163. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka paraqitur një kërkesë të datës 25.01.2013, për heqje dorë nga shqyrtimi i një tjetër çështjeje civile, nr. {***}, e cila i ishte caktuar për gjykim më datë 08.11.2012 dhe në të cilën palë ishte znj. P. M.. Nga përmbajtja e kësaj kërkesë, rezultoi se znj. P. M., në cilësinë e administratores së shoqërisë “{***}” ShPK, kishte kërkuar përjashtimin e subjektit nga gjykimi, duke pretenduar se shoqëria që ajo përfaqësonte dhe bashkëshorti i subjektit, me profesion noter, kishin pasur marrëdhënie pune. Subjekti ka shpjeguar se, pasi është njohur me këto pretendime dhe ka komunikuar me bashkëshortin e saj, ka çmuar se ishte e nevojshme të hiqte dorë nga gjykimi në zbatim të neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo kërkesë është pranuar nga kryetari i gjykatës me vendimin e datës 28.01.2013.
164. Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka arritur të japë shpjegime bindëse lidhur me situatën e konfliktit të interesit në çështjen civile nr. {***}, datë 09.03.2011, për të cilën i ishte kaluar barra e provës.
165. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, referuar akteve të administruara, pavarësisht se pala e paditur nuk rezultoi të jetë individualizuar plotësisht në aktin e padisë, subjekti kishte dijeni se padia drejtohej ndaj trashëgimtarëve të z. A. M., me të cilin bashkëshorti i saj kishte lidhur në vitin 2008 aktmarrëveshjen për shitjen e njësisë tregtare me sipërfaqe 34,5 m². Kjo marrëdhënie juridiko-civile rezultonte ende e papërfunduar në kohën e shqyrtimit të çështjes, për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me sipërfaqen dhe çmimin e objektit me bashkëshortin e të ndjerit, znj. P. M..
166. Në këto kushte, ndonëse nga vendimi për kthimin e padisë, rezultoi se pala e paditur nuk ishte individualizuar në mënyrën e kërkuar nga neni 153, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile, paditësi kishte identifikuar si palë të paditur trashëgimtarët e z. A. M.. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit kishte dijeni se çështja lidhej me persona me të cilët familja e saj ndodhej në një marrëdhënie juridiko-civile të papërfunduar.
167. Referuar nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete edhe *në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie*. Në të njëjtën linjë, neni 73 i këtij Kodi parashikon se gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, duhet t'i kërkojë kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij.

168. Sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të zyrtarit, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Ndërkohë, neni 5, pika 1, shkronja “b” e këtij ligji përcakton se interesat privatë përfshijnë edhe interesat që burojnë nga marrëdhënie juridiko-civile.
169. Nga analiza e situatës faktike në raport me kuadrin ligjor të zbatueshëm, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes civile ku palë të paditura kanë qenë trashëgimtarët e z. A. M., ndonëse bashkëshorti i saj ndodhej prej vitit 2008 në një marrëdhënie juridiko-civile me këtë shtetas, marrëdhënie e cila kishte vijuar edhe pas vdekjes së tij me trashëgimtarët ligjorë.
170. Në këto kushte, duke mos kërkuar zëvendësimin e saj me qëllim shmangien e çdo dyshimi të arsyeshëm mbi paanësinë, subjekti e ka vendosur veten në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Kjo situatë do të ekzistonte pavarësisht përmbajtjes së vendimmarrjes së marrë prej saj në çështjen konkrete.
171. Lidhur me çështjen civile nr. {***}, e cila i është caktuar subjektit për gjykim më datë 08.11.2012, trupi gjykues konstaton se vetë subjekti ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi i saj, pasi znj. P. M. kishte kërkuar përjashtimin e saj, duke pretenduar ekzistencën e marrëdhënieve profesionale ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit të subjektit.
172. Megjithëse subjekti ka vepruar në përputhje me nenet 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, duke kërkuar zëvendësimin e saj dhe kjo kërkesë është pranuar nga kryetari i gjykatës, trupi gjykues vëren se edhe në këtë rast, shkak për heqjen dorë nuk kufizohej vetëm në marrëdhëniet profesionale të bashkëshortit me shoqërinë “{***}” ShPK, por buronte edhe nga ekzistenca e marrëdhënies juridiko-civile të papërfunduar dhe konfliktuale me znj. P. M., e cila vazhdonte në kohën e shqyrtimit të çështjes.
173. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se konstatimet e Komisionit në lidhje me ekzistencën e një situatë konflikti interesi në këto dy raste, janë të bazuara.
174. Megjithatë, trupi gjykues çmon se kjo situatë duhej të vlerësohej në kuadër të kriterit të aftësive profesionale, konkretisht në lidhje me indikatorin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016. Për nga natyra dhe pesha e saj, ajo është e pamjaftueshme për t'u trajtuar si një çështje autonome në kuadër të kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, në këtë pjesë, arsyetimi i Komisionit nuk gjen mbështetje të plotë ligjore.

➤ *Në lidhje me deklarin e adresës së banimit/vendqëndrimin:*

175. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për të deklaruar banesën e nënës së saj në DPV ndër vite, si adresë banimi apo si vendqëndrim tjetër, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ndërkohë që edhe në deklaratën vetting në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk ka deklaruar posedimin/përdorimin e banesës në pronësi të nënës së saj L. B.. Nga ana tjetër, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka vijuar me pohime të*

*pavërteta duke deformuar realitetin, pasi ka deklaruar se ka banuar në apartamentin me sip. 151 m² në pronësi të bashkëshortit të saj, me adresë lagjja “{***}” dhe vetëm në parashtrimet e veta, pasi Komisioni evidentoi mospërdorimin e këtij apartamenti nëpërmjet të dhënave të FSHU-së, subjekti ka deklaruar se kjo ka ndodhur pasi ajo dhe familja e saj kanë banuar në shtëpinë e nënës së saj. Ky qëndrim i subjektit vërteton se deklaratimet e mëparshme të saj në lidhje me adresën e banimit, kanë qenë të rreme. Ky fakt dhe mosdeklarimi në mënyrë të vijueshme i një pasurie në përdorim, banesës së nënës së saj, përveçse vijnë në kundërshtim me etikën e një magjistrati, ka vështirësuar punën e Komisionit për evidentimin e investimeve të mundshme në banesën e nënës së subjektit ndër vite. Për pasojë, Komisioni vlerëson gjithë qëndrimin e subjektit si përpjekje për të fshehur përdorimin e banesës së nënës së saj e, për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.*

176. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vlerësim, duke pretenduar se: (i) Komisioni nuk ka evidentuar shkeljen konkrete të etikës që pretendohet të jetë kryer prej saj dhe nuk ka referuar ndonjë standard apo vendim të GjEDNj-së që mbështet vlerësimin për një sjellje të supozuar joetike; (ii) në vendim mungon analiza e fakteve në raport me parashikimet e ligjit nr. 96/2016 dhe normat e Kodit të Etikës; dhe (iii) nuk është provuar që subjekti të ketë kryer veprime të kundërligjshme apo të ketë mbajtur një sjellje që cenon etikën e gjyqtarit, veçanërisht duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një situatë familjare jo të zakonshme, ku përpjekja për të ruajtur ekuilibrat familjarë dhe për t'u kujdesur për nënën e saj është interpretuar gabimisht si shkelje etike.
177. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit të Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton dhe vlerëson si vijon.
178. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar si adresë banimi apartamentin e ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, pallati nr. {***}, Shkodër, ndërsa në rubrikën “Vendqëndrim tjetër/Adresë e plotë banimi” kanë deklaruar: “Nuk disponoj”. Po ashtu, në rubrikën për deklarimin e pasurive, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar ndonjë pasuri në posedim apo në përdorim.
179. Nga deklaratat periodike vjetore ndër vite²⁹, rezulton se subjekti ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme si adresë banimi lagjen “{***}”, rrugën “{***}”/bulevardin “{***}”, pallati nr. {***}, kati {***}, pa deklaruar ekzistencën e ndonjë vendqëndrimi tjetër.
180. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se që prej datës 01.06.1999, ka jetuar në apartamentin nr. {***}, në lagjen “{***}”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ajo ka deklaruar gjithashtu se apartamenti me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në të njëjtën lagje, është përdorur vetëm prej saj, bashkëshortit dhe dy fëmijëve të tyre, ndërsa pas vdekjes së prindërve të bashkëshortit, të dy apartamentet, me sipërfaqe totale 151 m², janë përdorur vetëm nga familja e saj.

²⁹ Në DIPP-2011 nuk ka deklaruar adresë, në DIPP-2015 deklaron: “Njësia Administrative nr. {***}, bulevardi “{***}”, Bashkia Shkodër.

181. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit, sipas informacionit të përcjellë nga FSHU-ja³⁰, rezulton se niveli i konsumit të energjisë elektrike në të dyja kontratat³¹ që lidhen me apartamentet në pronësi të bashkëshortit të subjektit, nuk është në përputhje me përdorimin e vazhdueshëm të tyre nga një familje.
182. Nga analiza e këtyre të dhënave, rezulton se, për pjesën më të madhe të periudhës së verifikuar, faturimet janë në vlera *aforfe* ose të papërfillshme, ndërsa për periudhën nga muaji shtator 2013 deri në muajin korrik 2021 nuk rezulton asnjë konsum energjie elektrike për të dyja kontratat, me përjashtim të muajve korrik, gusht dhe shtator 2022 për kontratën {***}.
183. Vetëm në parashtrimet e paraqitura pas rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar për herë të parë se mungesa e konsumit të energjisë elektrike në apartamentet e deklaruar prej saj si vendbanim, ka ardhur për shkak se ajo dhe familja e saj kanë banuar në banesën e nënës së saj në rrugën “{***}”, Shkodër, pasuri e trajtuar në paragrafët 71-74 të vendimit të Komisionit.
184. Subjekti ka shpjeguar se, pas largimit të vëllezërve të saj jashtë Shqipërisë në fillim të viteve '90, nëna e saj kishte mbetur e vetme dhe familja kishte vendosur të jetonte së bashku, në mënyrë që ajo të kujdesej për të, ndërkohë që afërsia e shkollës së fëmijëve përbente një tjetër arsye praktike për këtë zgjedhje. Sipas saj, edhe pas vdekjes së nënës në vitin 2014, ajo dhe bashkëshorti kanë vijuar të jetojnë në këtë banesë, për shkak të nevojave të fëmijëve që në atë periudhë ndiqnin gjimnazin në afërsi të saj.
185. Referuar kësaj situate faktike, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar me vërtetësi adresën reale të banimit, të cilën e ka bërë të ditur vetëm pasi Komisioni konstatoi, nëpërmjet të dhënave të FSHU-së, se apartamenti i deklaruar si vendbanim, nuk rezultonte të ishte përdorur në mënyrë të vazhdueshme.
186. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 84/2016, subjektet deklaruese kanë detyrimin të plotësojnë deklaratat sipas formularëve përkatës, duke deklaruar adresën e plotë të regjistrimit në gjendjen civile dhe, në rast se disponojnë një vendqëndrim tjetër, të deklarojnë edhe këtë adresë. Në rastin konkret, ky detyrim nuk rezulton të jetë përmbushur me saktësi dhe vërtetësi nga subjekti i rivlerësimit.
187. Për më tepër, duke qenë se vetë subjekti ka pohuar se ajo dhe familja e saj kanë banuar për vite me radhë në banesën e nënës së saj dhe se kanë vijuar ta përdorin këtë banesë edhe pas vdekjes së saj, trupi gjykues vlerëson se subjekti kishte detyrimin, në përputhje me nenin 3, pika 11 e

³⁰ *Shih e-mail-in, datë 24.02.2023, në dosjen e Komisionit. FSHU-ja nuk ka konfirmuar të ketë kontratë të lidhur me subjektin dhe personat e lidhur me të në këtë adresë. Subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr. {***}, si dhe librezë të energjisë elektrike për kontratën me nr. {***}, të dyja në emër të z. L. R., vjehrrit të saj. Sipas shpjegimeve të subjektit, emri i babait të bashkëshortit ka mbetur si emër klienti, duke lënë të kuptohet se këto dy kontrata i përkasin apartamentit me sipërfaqe 76 m² të blerë në vitin 1998 dhe apartamentit me sipërfaqe 75 m² të përfitur nga bashkëshorti i subjektit me dhurim nga prindërit e tij më datë 5.11.1997, të cilët janë bashkuar në një të vetëm.*

³¹ *Për kontratën nr. {***}, nga janari 2007 ka faturime aforfe në vlerat të vogla, me përjashtim të muajve korrik-gusht-shtator 2022; (ii) për kontratën me nr. {***}, në periudhën janar 2007 deri shtator 2013, ka faturime të konsumit të energjisë elektrike që variojnë në vlera të ndryshme, ndërsa nga shtatori i vitit 2013 deri në korrik të viti 2021, rezultojnë faturime aforfe në vlera të vogla. Pas kësaj periudhe, vërehet e njëjta situatë, me përjashtim të disa muajve ku vërehet konsum i energjisë elektrike.*

ligjit nr. 84/2016, ta deklaronte këtë pasuri si pasuri në përdorim. Ky detyrim nuk rezulton të jetë përmbushur.

188. Në përgjigje të pretendimit të subjektit se kjo situatë është konsideruar në mënyrë të pabazuar si shkelje etike, trupi gjykues konstaton se, referuar paragrafit 27 të vendimit të Komisionit, ky i fundit e ka vlerësuar mosdeklarimin e adresës reale dhe të përdorimit të banesës së nënës si një sjellje në kundërshtim me etikën dhe si një rrethanë që ka vështirësuar procesin e verifikimit në kuadër të kontrollit të pasurisë.

189. Megjithatë, pasojën juridike të kësaj situatë, Komisioni nuk e ka lidhur me një vlerësim autonom në fushën e etikës, por me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke e trajtuar atë si situatë të deklarimit të pasaktë të adresës së banimit dhe të mosdeklarimit të një pasurie në përdorim.

190. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *vetting*, duke mohuar ekzistencën e një vendqëndrimi tjetër, ndonëse në momentin e plotësimit të deklaratës, banonte realisht në banesën e nënës së saj. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 54 m², ndodhur në qytetin e Shkodrës:*

191. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se: *pavarësisht se pasuria e blerë në vitin 1996 dhe shitur në vitin 1997 i përket një periudhe të hershme e para se subjekti të bëhej subjekt deklarues dhe moskryerja e deklarimeve në lidhje me këtë pasuri nuk ka ndonjë pasojë direkte në funksion të procesit të rivlerësimit, çmohet se subjekti i rivlerësimit dështoi të argumentojë bindshëm se nuk ka lidhje me këtë pasuri, ndërkohë që vërehet se, pasi ka marrë dijëni në lidhje me këtë pasuri pas pyetjes në ILDKPKI në vitin 2021 e deri në momentin e njohjes me rezultatet e hetimit, nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të vërtetuar këtë fakt. Po kështu, në mënyrë të pakuptueshme, pas njohjes me barrën e provës, subjekti ka kërkuar vetëm ekspertimin e nënshkrimit në kontratën e blerjes së pasurisë të vitit 1996, ku ajo figuron në cilësinë e palës blerëse, dhe jo të kontratës së shitjes së vitit 1997, ku ajo është në cilësinë e palës shitëse, duke thelluar edhe më shumë dyshimet në lidhje me pasurinë objekt verifikimi. Në referim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, kjo sjellje e përsëritur e subjektit të rivlerësimit me deklarime që nuk përkojnë me realitetin, deklarime kontradiktore dhe jokoherente, është marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes, në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*

192. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se gjetjet e Komisionit në lidhje me këtë pasuri, janë të pambështetura, pasi ajo ka argumentuar dhe provuar se nuk ka qenë asnjëherë pronare e këtij apartamenti dhe se nuk ka pasur asnjë të drejtë reale mbi të.

193. Sipas subjektit, ajo ka marrë dijëni për ekzistencën e kontratave vetëm gjatë procesit të rivlerësimit dhe, për shkak të parashkrimit të veprës penale, nuk ka paraqitur kallëzim penal, ndërsa nuk ka kërkuar as pavlefshmërinë e kontratave në gjykatë, pasi nuk ka pasur interes të ligjshëm për ngritjen e një padie të tillë dhe i mungon legjitimiteti aktiv për ta ushtruar atë.

194. Duke ripërsëritur argumentet e paraqitura në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti pretendon se ngarkesa negative që përshkon arsyetimin e vendimit, tregon se Komisioni ka

synuar, në çdo mënyrë, të krijojë përshtypjen se ajo nuk e ka merituar ushtrimin e detyrës së gjyqtares.

195. Në shqyrtim të këtij pretendimi, referuar akteve të administruara në fashikull dhe arsyetimit të vendimit, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë pasuri dhe rrethanat e evidentuara për të, nuk është kualifikuar sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Kjo për shkak se pasuria objekt shqyrtimi rezulton të jetë blerë në vitin 1996 dhe shitur në vitin 1997, përpara se subjekti i rivlerësimit të fitonte cilësinë e subjektit deklarues.
196. Megjithatë, në referim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar se sjellja e subjektit të rivlerësimit në raport me shpjegimet dhe deklaratimet e dhëna gjatë procesit, duhet të mbahet në konsideratë në kuadër të vlerësimit tërësor dhe përfundimtar të çështjes, duke ndikuar në orientimin e vendimmarrjes në favor të aplikimit të masës disiplinore.
197. Trupi gjykues vëren gjithashtu se Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka vlerësuar në mënyrë të përgjithshme sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, duke evidentuar se, ndonëse ajo ka treguar gatishmëri për t'iu përgjigjur kërkesave të Komisionit, në disa raste³² përgjigjet e saj kanë rezultuar në kundërshtim me faktet dhe rrethanat e deklaruara më parë prej saj, ndërsa në raste të tjera nuk janë shoqëruar me dokumentacionin provues të kërkuar.
198. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit përgjigjet e subjektit nuk kanë qenë shteruese dhe kjo rrethanë duhet të konsiderohet si tregues i mungesës së bashkëpunimit, nuk është i drejtë.
199. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mban në konsideratë se vlerësimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të mjaftueshmërisë së tyre, nivelit të detajimit apo aftësisë për të provuar pretendimet e ngritura, lidhet drejtpërdrejt me çështjen e përmbushjes ose jo të barrës së provës nga subjekti. Për rrjedhojë, pamjaftueshmëria e shpjegimeve ose mungesa e provueshmërisë së tyre mund të sjellë pasoja në drejtim të vlerësimit të pretendimeve konkrete të subjektit, por nuk mund të interpretohet automatikisht si mungesë bashkëpunimi ndaj procesit të rivlerësimit kalimtar.
200. Në mungesë të rrethanave konkrete që të evidentojnë refuzimin për t'iu përgjigjur kërkesave të Komisionit, pengimin e zhvillimit të hetimit administrativ apo moszbatimin e detyrimeve procedurale nga ana e subjektit, trupi gjykues vlerëson se nuk ka bazë për të konsideruar qëndrimin e saj si sjellje jobashkëpunuese në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.
- Në lidhje me pasurinë e llojit *autoveturë*, e tipit “{***}”:
201. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë e tipit “{***}”, me targë {***}, me leje qarkullimi nr. {***}, e regjistruar në DPSHTRR {***} në emër të bashkëshortit, blerë që më datë 28.10.2008, me të ardhurat nga puna, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 1.000 euro. Pjesa: 50%.*

³² Rastet e identifikuar nga Komisioni se subjekti nuk ka dhënë sqarime lidhen me depozitën e deklaruar në apartamentin 54 m², deklarin e adresës, si dhe disa konstatime që lidhen me disa nga denoncimet e trajtuara nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.

202. Komisioni, pas kontrollit të kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për blerjen dhe zhdoganimin e autoveturës. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkak ankimi lidhur me këtë pasuri dhe, si rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit mbetet i pandryshuar.
203. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit, bazuar në konkluzionet e arsyetuara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi nr. 647, datë 14.04.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 647, datë 14.04.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Izabela Radovani.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.09.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi